Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / www.kmsh.al

DRITA ISLAME

Kurani, kandil ndriçues i mendjes dhe shpirtit

ISSN 2226-7115
04
9 772226 711008

Viti XXIX / Nr. 5-6 / Maj-Qershor 2020 / Çmimi: 150 Lekë / www.dritaislame.al

Revista Drita Islame rikthehet në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

URTËSI

BOTA JONË

FAMILJA

REFLEKSIONE

PERSONALITETE

www.dritaislame.al

"Drita islame"
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

REDAKTORË
Andrin Rasha
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Ejup Lila

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXIX i botimit
Nr. 5-6 (448-449)
Maj-Qershor, 2020

ISSN 2226-7115

*Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,
nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.
Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.*

PËRMBAJTJA

4 Kurani, kandil ndriçues i mendjes dhe shpirtit / Dorian Demetja
6 Kënaqësia e jetës në kënaqësinë e zemrës / Nuredin Nazarko
8 Lajme / Aktivitete

12 Kam një brengë, nuk e ndërroj as me një mijë gëzime / Mehmet Disha
16 Bazat metafizike të sëmundjes 2 / Prof. Dr. Ajhan Tekinesh
18 Sakrificat e Sahabëve në misionin e kumtimit të fesë/ Taulant Bica
20 Idhujt e gjallë: Lat, Uzza dhe Menat
22 Orteku i punëve të mira / Osman Xhili
26 Isuf Luzaj, djali i hoxhës së Kaninës, Vlorë / Hysen Kobellari

30 Thërrime urtësie
32 Hatixhja r.a. modeli i gruas në Islam / Jonida Cikalleshi
34 Kruajtja, një mënyrë si na "flet" lëkura jonë / Fatma Gunduz
38 Faleminderit Zoti im
39 Më dëgjoni edhe pse jam i vogël

| DORIAN DEMETJA |

Kurani, kandil ndriçues i mendjes dhe shpirtit

Kurani, si libri i fundit hyjnor, është i pacenueshëm dhe i pandryshueshëm deri në ditën e fundit të kësaj bote, kjo për faktin se vetë Zoti e ka marrë nën mbrojtje prej armiqve të mundshëm. Nëse do ta shprehnim me një fjali gjithëpërfshirjen e tij, do të thoshim se Kurani tregon raportin mes individit dhe Krijuesit, mes individit me veten e tij dhe mes individit me shoqërinë. Kurani është i vetmi libër që urdhëron drejtësinë e vërtetë, lirinë e vërtetë, barazinë e drejtpeshuar, dobinë, nderin, virtytin, dhembshurinë ndaj të gjitha qenieve, gjer te kafshët, që ndalon hapur dhunën, politeizmin, padrejtësinë, injorancën, mitet, fajdenë, gënjeshtrën, dëshminë e rreme...

Kurani është fjalë hyjnore e zbritur për njeriun, për t'i dhënë atij mundësinë që të jetë bashkëbisedues me Zotin dhe meritor i emërtimit "krijim i bukur". Në klimën e ndritshme të Kuranit, njeriu bëhet pjesë e realitetit fizik e shpirtëror, sheh ringjalljen dhe Siratin, mendon për dënimin e shpërblimin dhe aspiron të shëtisë në majat e gëzuara të parajsës... Zoti urdhëron e thotë: "Sikur këtë Kuran t'ia shpallnim ndonjë mali, ti do ta shihje atë (malin) të përulur dhe të copëtuar nga frika e Allahut. Shembuj të tillë Ne ua japim njerëzve që ata të meditojnë." (Hashr, 59:21)

Po qe se, duke iu marrë parasysh madhështia, do t'u ishte zbritur maleve, do të shihnim se si malet do të bëheshin copë-copë. Sigurisht, nga mbresa dhe tronditja para Allahut, malet do të rrënoheshin, kurse njeriu s'pëson gjë, sepse e mban mendjen dhe zemrën larg Kuranit. Njeriu, i cili nuk i bën vend Kuranit në mendje dhe në botën e vet të brendshme, gjithsesi nuk do të ketë pjesë prej tij. Myslimanët kanë mundur të arrijnë unitetin mes tyre vetëm me anë të besimit dhe besnikërisë ndaj Kuranit dhe kështu ka për të ndodhur edhe në të ardhmen. Ata që nuk i qëndrojnë besnikë Kuranit, jo vetëm që s'mund të jenë besimtarë të mirë, por edhe as që mund të ngrenë një unitet të qëndrueshëm mes tyre.

Problemi qëndron në qasjen ndaj metodologjisë hyjnore, me ç'rast myslimani i mëhershëm bashkëvepronte me Kuranin në sajë të faktit se është sistem i vlerave, udhërrëfyes, kandil ndriçues, ushqyes i mendjes dhe shpirtit, platformë e shëndoshë për ndërtimin e institucioneve të sistemit, frymëzues, që njeriut i ofron përgjigje për pyetjet më enigmatike: kush është ai, nga erdhi dhe si do të jetë fundi i tij dhe botës që e rrethon, kush e krijoi universin, cila është zanafilla e tij?, etj. Libër, i cili myslimanëve ua mësoi parimet për projektin madhështor për ngritjen e një qytetërimi të paparë deri atëherë. Praktikisht kjo ndikonte pozitivisht në lidhjen dhe qasjen serioze ndaj Kuranit Fisnik.

Qasja jonë e gabuar manifestohet në faktin e anashkalimit të njohurive dhe të vërtetave kuranore, ku kryesisht bëhet lexim sipërfaqësor larg meditimit, analizimit të argumenteve racionale, që i drejtohen njeriut, porosive për ngritje morale e shpirtërore. Sistem, të cilin e kishte praktikuar vetë Profeti (a.s.) duke i mësuar shokët e tij, që raporti i tyre ndaj Kuranit të jetë raport bashkëveprimi, i cili duhet materializuar në jetën e përditshme, sikur janë porositë, udhëzimet, urdhëresat e ndalesat kuranore.

Por sot, raporti ynë me Kuranin është sipërfaqësor. Sa për ilustrim, më tepër na intereson sa ishte i gjatë Ademi (a.s.), sa gërma ka Kurani, kush i lidhi në martesë Ademin me Havën, etj. Para nesh kalojnë një numër i madh ajetesh, të cilat ftojnë në logjikë, meditim, që dëshmojnë për përsosurinë e krijimit të njeriut, për marrëdhëniet njerëzore, etj. Jo më kot Zoti, në Kuran, thotë: "A nuk e studiojnë me vëmendje Kuranin? Por jo, ata i kanë zemrat e kyçura". (Muhamed, 47:24)

Si përfundim, me gjithë problematikat e veta, shoqëria njerëzore, sot e gjithmonë, gjen në Kuran mesazhin e Krijuesit, i Cili e udhëzon njerëzimin se si të gjejë rrugën e shpëtimit dhe çelësat e lumturisë. Kurani i nxit të gjithë njerëzit, femra e meshkuj, që të kërkojnë diturinë e dobishme, të dallojnë të mirën nga e keqja, të punojnë e të fitojnë me djersën e ballit. Meqenëse Kurani është një libër formues e orientues, që kultivon dashuri dhe mbjell frymë paqeje, njerëzit duhet të jetojnë me të, sepse ai është udhërrëfyes për të gjithë ata, të cilët iu përmbahen këshillave dhe mësimeve të tij.

| NUREDIN NAZARKO |

Kënaqësia e jetës në kënaqësinë e zemrës

Nuk ka njeri që nuk ëndërron për jetë të paqtë. Njeriut nuk i pëlqejnë dhimbjet dhe vuajtjet që ato sjellin nga pas. Shkaktojnë lodhje, mërzi, dëshpërim e deri humbjen e shijes së jetës. Frika për të humbur paqësinë e asaj që shihej si e sigurt dhe e pacenueshme sjell ankthin e së nesërmes. Ankthi është gjithnjë shoqërues i njeriut, sepse gjithmonë njeriu shpreson për të nesërmen. Por ankthi që sjell trazimi se mund të humbasim jetën e paqtë dhe me këtë humbje nuk dihet çfarë vjen pas (edhe në kushte të tilla vdekja shihet ende si diçka e largët), nuk është i zhdukshëm në përkohësi.

Nuk është koha të kujtojmë vdekjen do të thonë syresh. Është koha të duam jetën. Jetën duhet ta duam, sepse nuk na është dhënë për ta urryer, por pa kaluar përmes vdekjes nuk mund të mbërrihet tek jeta. Të duash jetën nuk do të thotë të harrosh vdekjen dhe të vdesësh para se të jetosh. Të duash jetën do të thotë t'i japësh jetë zemrës, sepse pa lulëzimin e saj as jeta nuk mund të lulëzojë.

Paqësia e jetës lidhet me paqësinë e zemrës. Pa këtë as nuk mund të mendosh se do të arrish të përjetosh bukurinë e jetës, bukurinë e çdo dite të re. Ankthi se çdo të ndodhë nuk është diçka që trazon vetëm zemrën. Ky është trazim i nevojshëm, pasi njeriu është harrues i madh ndaj të mirave që e rrethojnë dhe për të cilat as ka paguar ndonjë çmim. Njeriu i jep vlerë asaj për të cilën paguan, sepse ka harxhuar mund e djersë për të siguruar vlerën që paguan. Po sa mirësi ka njeriu për të cilat nuk paguan? Kur njeriu bëhet harrues i këtyre mirësive, atëherë ndodhin ngjarje, të cilat sjellin frikë dhe ankth për të nesërmen. Në këtë çast njeriu nuk duhet të lëshojë veten në duart e pesimizmit apo, akoma më keq, të depresionit, por duhet të vetmohet e të reflektojë. Të reflektojë për sytë me të cilët sheh agimin e çdo dite të re, sistemet e organeve që e mbajnë gjallë fizikisht, ajrin që thith, e ngrohtësinë e rrezeve të diellit. Të reflektojë ndaj çdo gjëje për të cilën nuk ka paguar dhe pa të cilat nuk mund të jetojë as disa sekonda.

Zotërimi i të mirave materiale nuk është krejt i padobishëm apo i mallkuar. Është keqpërdorimi i tyre, që e bën njeriun të ndryshojë perceptimin për të pasurin dhe pasurinë. Nëse do të përdoreshin drejt dhe me mirësi, bashkësia njerëzore do të kishte një pamje krejt tjetër. Raportet mes njerëzve do të ishin po ashtu krejt ndryshe nga sa i shohim të jenë aktualisht. Edhe pse fara e së mirës asnjëherë nuk humb, shtimi i barërave të këqija ia ndal hovin, ia zbeh bukurinë, dhe nuk e lejon t'i japë bashkësisë njerëzore shkëlqimin që i takon. Njeriu, duke mos e ndjerë këtë shkëlqim, kujton se e mira e ka humbur davanë dhe për të bërë prokopi në këtë jetë duhen ndezur motorët e hiles, mashtrimit, ngrënies në peshë, në masë, dhe, mundësisht, duhen shtrirë aftësitë hajduteske në çdo kapilar të mundshëm të shoqërisë. Kush ia del mbanë kësaj nisme të errët cilësohet i zoti, i aftë, madje edhe lavdërohet dikush me të tilla cilësi, ndërsa kushdo që përpiqet të mbajë gjallë të mirën, virtytet, duke qenë antipod i kësaj sjelljeje shihet si teveqel, teleshman, i pazoti. Nëse ky është vlerësimi për modelet jetësore në një shoqëri a mund të pritet që barërat e këqija t'ia lirojnë rrugën farës së mirësisë?!

Nëse njeriun e shqetëson kjo gjendje, ky shqetësim duhet me patjetër të kthehet në një reflektim të thellë mbi faktin se çfarë bën njeriu me jetën e tij? Si e përdor ai atë? A është mendja e tij e kthjellët ndaj zbukurimeve mashtruese të së keqes, që përpiqet të duket si një sojlie e ndërkohë në gji mban zjarrin e urrejtjes dhe vrerin e zilisë dhe hasedit? A ka ky njeri një pishtar

ndriçues që e bën të dallojë qartë të mirën dhe të keqen? Nuk mund ta shuash këtë pishtar me thellimin në të liga e më pas të shfrysh ndaj farës së të mirës që nuk jep fryte. Ky do të ishte gjykim krejt i gabuar, gjykim të cilin nuk mund ta pranojë njeriu që mban brenda vetes ndezur pishtarin dallues të së mirës dhe të së keqes.

Ditët që i janë dhënë njeriut për të jetuar janë të tijat dhe askush nuk mund t'ia marrë apo t'ia huajë. Por këto ditë kurrë nuk do të kenë të njëjtën trajtë. Luhatjet në pamjen e tyre do të jenë gjithmonë normale. Mes këtyre luhatjeve njeriu duhet të qëmtojë çastet, ditët, kur lidhja me të mirën dhe largimi nga e keqja janë në pikun e tyre. Kjo për të përfituar rigjallërim të zemrës, çlirim të saj nga pesha e stomakut, lehtësim të gjymtyrëve nga pesha e të ligave që njeriu vepron. Vullneti dhe këmbëngulja për t'i shkuar pas farës të së mirës porsi manar, duhet të kthehen në epiqendër të veprimit dhe jo thjesht të fjalëve që erërat dhe stuhitë nuk dihet se ku i degdisin.

Pa veprim që i jep jetë farës të së mirës, nuk ka gjallëri dhe paqësi jeta e njeriut. Kushdo që e kërkon gjallërinë dhe paqësinë jashtë kësaj rruge, jeton mes fanitjeve pa arritur kurrë të shijojë jetën që mendon se e ka shijuar e i ka pirë lëngun, kur ka vepruar siç i ka dashur qejfi, pa njohur kurrfarë virtyti.

1 KONFERENCA E TRETË NDËRKOMBËTARE NË STUDIMET ISLAME, ME TEMË: "ISLAMI DHE SFIDAT E FAMILJES NË SHOQËRINË BASHKËKOHORE".

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Islame, pranë Kolegjit Universitar "Bedër", dhe Këshillin Botëror të Komuniteteve Myslimane, zhvilluan Konferencën e Tretë Ndërkombëtare në Studimet Islame, me temë: "Islami dhe sfidat e familjes në shoqërinë bashkëkohore".

Kjo konferencë mblodhi së bashku mbi 20 akademikë dhe studiues, të cilët, në referimet e tyre, u fokusuan në trajtimin e temave të ndryshme rreth rolit, rëndësisë dhe sfidave që familja po has çdo ditë.

Konferenca u fokusua mbi rëndësinë dhe sfidat që po has çdo ditë familja në shoqërinë shqiptare dhe jo vetëm.

2 PROGRAMI I KOMUNITETIT MYSLIMAN TË SHQIPËRISË PËR MUAJIN E BEKUAR TË RAMAZANIT

Përgjatë çdo dite të muajit të madhërishëm të Ramazanit, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është fokusuar në tre pika kryesore për të gjallëruar aktivitetin e përditshëm të besimtarëve, duke qenë vazhdimisht aktiv në rrjetet sociale, në pamundësi të ligjëratave me pjesëmarrje fizike, si pasojë e karantinës që shkaktoi pandemia e Covid-19.

Programi i një dite, përbëhej fillimisht me nisjen e mësimeve rreth leximit në gjuhën amë të Kuranit Famëlartë, të emërtuara "Drejt leximit të Kuranit fisnik".

Programi i dytë, ka vijuar me seancat live të leximit të përbashkët të Kuranit Fisnik, të quajtura Mukabele. Më tej, programi i tretë i ditës, i emërtuar "Koha për Iftar", ka pasur një larmishmëri të ftuarish dhe tematikash, të cilat kanë pasur një ndikim dhe vlerë të madhe për ndjekësit.

3 SHPËRNDARJA E NDIHMAVE NGA ANA E MYFTINIVE

Në këto ditë të vështira për shqiptarët, Myftini të ndryshme u kanë ardhur në ndihmë familjeve në nevojë, ku janë shpërndarë mijëra pako me ushqimet bazë.

Organizime të tilla, në bashkëpunim me donatorë bamirës, do të vazhdojnë edhe gjatë ditëve në vijim, deri në qetësimin e situatës.

Profeti ynë i dashur thotë:

"Njeriu bujar është afër Allahut, afër Xhenetit, afër njerëzve, larg zjarrit."

Allahu i shpërbleftë dhuruesit dhe i ndihmoftë nevojtarët!

4 FILLON NDËRTIMI I BANESAVE NGA FONDI I TËRMETIT

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka nisur implementimin e fondit të mbledhur nga tërmeti.

Nisja e punimeve ka filluar në fshatin Ndroq të Tiranës. Shtëpia pas tërmetit ishte e pabanueshme. Familja që jetonte aty përbëhej nga 5 anëtarë dhe pas rënies së tërmetit ishte strehuar tek të afërmit.

Kryefamiljari me lot në sy tregon momentet drithëruese të tërmetit: "Nga njëra anë kisha prindërit e moshuar e të pamundur dhe nga ana tjetër kisha fëmijët, nuk dija nga të shkoja më parë, ngelëm të gjithë të ngrirë, por desh Zoti banesa nuk u shemb të na zinte brenda, pavarësisht dëmtimeve që kishte marrë."

Ata e pritën me një entuziazëm të jashtëzakonshëm fillimin e punime për ngritjen e banesën së tyre të re, duke e shoqëruar me lutje të shumta dhe falënderime të përzemërta për të gjithë donatorët që mundësuan ndërtimin e shtëpisë së tyre.

Drejtori i Vakf-Investimeve dhe Financës në KMSH, z. Edison Hoti, tha se ky është një amanet i donatorëve që po çohet në vend.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë falënderon të gjithë ata që kontribuuan në mbledhjen e fondit të tërmetit dhe të mbështetjeve të tjera pranë njerëzve në nevojë.

Profeti Muhamed (a.s) thotë: "Sadakaja më e mirë është ajo e cila është e paktë, por e vazhdueshme."

Allahu jua shpërbleftë!

5 TAKIMI ONLINE I KRYETARIT TË KMSH-së ME AMBASADOREN E SHBA-së

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Bujar Spahiu, ka zhvilluar një takim online me Ambasadoren e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, znj. Yuri Kim.

Gjatë këtij takimi online kryetari KMSH-së i uroi znj. Kim mirëseardhjen në Shqipëri dhe suksese në detyrën e saj të re.

Në vijim z. Spahiu e njohu ambasadoren Kim me historikun e KMSH-së, ecurinë e tij gjatë këtyre viteve, sfidat e institucionit si dhe rrjetin arsimor të KMSH-së, me Medresetë dhe Universitetin Bedër.

Ai gjithashtu falënderoi ambasadën e SHBA-ve në Shqipëri për bashkëpunimin e ngushtë në projekte të ndryshme.

Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, znj. Yuri Kim fillimisht e uroi z. Spahiu dhe besimtarët myslimanë për muajin e Ramazanit. Më pas ajo shprehu konsideratën e saj të lartë për institucionin, vlerat që përfaqëson dhe rolin që luan në Shqipëri.

Znj. Kim e siguroi kryetarin Spahiu për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe e cilësoi KMSH-në si një partner strategjik të SHBA-ve në Shqipëri.

6 BESIMTARËT MYSLIMANË FALIN NAMAZIN E FITËR BAJRAMIT

Besimtarët myslimanë falën sot namazin e Fitër Bajramit në të gjithë xhamitë e vendit.

Ceremonia kryesore, ku ishte i pranishëm edhe kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, u zhvillua në xhaminë e "Kokonozit" (Pazari i ri), Tiranë.

Ndryshe nga vitet e tjera, falja e Fitër Bajramit këtë vit u zhvillua në të gjithë vendin, duke respektuar një protokoll të caktuar në kuadër të parandalimit të përhapjes së mëtejshme të COVID-19.

Ceremonia filloi me ligjëratën e rastit të mbajtur nga Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli, i cili pasi kërkoi mirëkuptim nga të gjithë besimtarët për masat e lartpërmendura, u fokusua mbi devotshmërinë, përkushtimin, sakrificën, solidaritetin, dashurinë dhe vëllazërinë mbarë-njerëzore që simbolizon muaji i bekuar i Ramazanit.

Kam një brengë nuk e ndërroj as me një mijë gëzime

Njeriu, duke qenë se është krijuar që të ketë një natyrë ndjesore të luhatshme, sprovohet në shumë mënyra. Përvoja jetësore e forcon atë për qëllime jetësore; çdo dhimbje, çdo pengesë, çdo gur, çdo gjemb dhe çdo udhë e stuhishme, është një projekt që e zhvesh njeriun nga të gjitha shtojcat e ngurta, nga çdo copëz teprie e kësaj bote, në mënyrë që njeriu, tanimë i pastruar, të mund të jetë përfundimisht vetvetja. Nëse njeriu është i gjithi i pastër, atëherë kjo i vlen atij për plotësimin e përsosurisë në këtë botë, që të mund të shkojë i mirë-përgatitur drejt amshimit.

Në të shumtën e rasteve, goditja e fatkeqësive nuk ka të bëjë me dimensionin e përmasshëm, por me mënyrën se si njeriu e percepton dhe e përthith atë në mendje. Kështu, ngjarja merr një realitet krejt tjetër, aq sa, vala e dhimbjes, e cila në botën e jashtme është shuar, valëvitet ndërkohë në mendimet e të përvuajturve. Megjithatë, Zoti nuk e rëndon kurrë njeriun me ç'ka këtij të fundit nuk i bart takati. Kjo na bën të mendojmë se origjina e dhimbjes në fakt është thjesht një fill i përkohshëm(,) që lidhet me urtësitë e caktimit të Zotit, dhe se ardhmja e dhimbjes përnjëmend është me dobi, e ndërkaq, shkëputja prej saj është forcim i mëtejshëm.

Sipas filozofëve të shquar, dhimbja (jo medoemos ajo fizike) ka dimensionet e saj dhe çdo individ do të kalojë nëpër procese jetësore të cilat do ta përballin atë me vuajtjen dhe ankthin. Sipas Kierkergardit vuajtja e njeriut është një nga pjesët më të rëndësishme të jetës njerëzore. Në çdo jetë njerëzore gjen vuajtje dhe, si pasojë, qeniet njerëzore i drejtohen dashurisë për tu marrë me këto vuajtje. Sidoqoftë, megjithëse dashuria është përdorur për t'u marrë me vuajtjet njerëzore, ajo gjithashtu mund t'i krijojë dhe shtojë vuajtjet, duke shkaktuar që situata të jetë më komplekse dhe e dhimbshme.

Përkohshmëria e natyrës njerëzore ngatërrohet atëherë kur njeriu përpiqet të ndërveprojë me zemër, kur kjo e fundit dashuron kinse përjetësisht dhe po ashtu, shpeshherë, edhe dhimbjen e projekton si të tillë. E sakaq, njeriu është i përkohshëm në këtë botë dhe asgjë nuk zgjat aq sa ai mendon se do të zgjasë, e asgjë nuk qëndron aq sa shpresohet (apo aq sa nuk shpresohet) që të ndodhë. Përjetësia është veçse në botën tjetër, si unifikim i cilësisë së shpirtit. Profeti Muhamed a.s. do të shprehej kështu: "E ç'lidhje kam unë me këtë botë? Unë në këtë botë s'jam veçse thjesht si një udhëtar që strehohet nën hijen e një peme, e më pas çohet dhe merr udhën e tij duke e braktisur atë." Prandaj, çdo element i hijes së zgjatur drejt fizikut tonë në këtë botë, është thjesht një mantel përkohësie që venitet me kalimin e kohës, pasi veç drita është e qëndrueshme, ndërsa hija dhe terri janë thjesht iluzion i mungesës së dritës. E përse të rrëmbehemi nga iluzioni?

Duhet ta çlirojmë mendjen nga çdo tis i llojeve të mendimeve që hijëzojnë dritën e besimit brenda nesh. Së pari, duhet të ndërkëmbejmë mendimet midis kësaj bote dhe botës së përtejme, sepse kjo e fundit është e qëndrueshme; kurse kjo botë është urë për fitimin e botës tjetër me anë të sprovave. Nuk duhen ngatërruar tiset e mendimeve të kësibotshme, me ajkën e ndjenjave shpirtërore të asibotshme. Për besimtarët e vërtetë, të cilët e kanë gjetur lumturinë te kënaqësia e Zotit, kjo botë është si Arafati. Si rrjedhojë, çdo ndodhi duhet të shihet me syrin e sprovës dhe mëshirës. Ashtu

siç hekuri i trajtës së parë lëndësore ka nevojë për nxehtësi të lartë në mënyrë që të marrë formën e aleteve, ashtu edhe njeriu, nëpërmjet fatkeqësive dhe sëmundjeve, pastrohet, e kështu edhe jeta e tij dëlirësohet, përsoset, forcohet dhe përparon; domethënë, arrin rezultate, fiton plotësim dhe përmbush qëllimin e saj.

Ndërkaq, jeta ndonjëherë kërkon tensionime në mënyrë që njeriu të zgjohet nga monotonia, kjo ngaqë një jetë jo ndryshuese, monotone, e cila kalon mbi divanin e rehatisë dhe mbi shtratin e lehtësisë, i ngjason më shumë mos-ekzistencës, e cila është e keqe e pastër, se sa ekzistencës e cila është e mirë e pastër. Kësisoj, tensionimi metafizik i brendshëm i njeriut është nevojë e qëllimit të ekzistencës, që njeriu të përsoset drejt idealit.

Në lidhje me këtë çështje, një dijetar i kohës sonë shprehet se mbrapshtitë dhe fatkeqësitë që kanë rënë mbi popujt myslimanë përgjat ë këtyre dekadave të fundit, kanë shkaktuar një tensionim metafizik tek ata, dhe kjo turbulencë shpirtërore ka shërbyer si kamxhik për të përshpejtuar forcën e tyre përtëritëse për t'u mëkëmbur drejt udhës së Zotit, sepse çdo e keqe e ka një të mirë dhe padyshim që e ka edhe një qëllim.

S'do mend se Zoti i sprovon njerëzit të cilët i do, sidomos profetët, por edhe dijetarët, besimtarët e të devotshmit . Kësisoj duhet të mendojmë gjithmonë prejardhjen e fatkeqësisë dhe sprovës, aq sa, duke e ditur se Zoti ka zgjedhur të na sprovojë, kjo domethënë se dëshira e Tij kërkon të na shtyjë për më lart, për më afër Tij, dhe në këtë mes nuk lihet hapësirë për hakërrim. Në shpalljen hyjnore, në Kuran, Zoti thotë: "Me të vërtetë, ai që ruhet dhe duron, Allahu nuk ia humb shpërblimin asnjë vepërmiri." Rumiu, i njohur për recetat e tij shpirtërore, do të shprehej kështu: "Kur shtëpiaket i nxjerrin tapetet në verandë, duke i goditur ato me shkop, qëllimi i tyre nuk është që të rrahin tapetet, apo t'i dënojnë ato, porse thjesht mëtojnë t'u heqin pluhurat; e atëherë, nëse Zoti yt kërkon që të të pastrojë prej pluhurave, ti s'ke arsye pse të mërzitesh."

Prezenca e zemrës në tensionin metafizik

Zemra e njeriut përtej muskulit dhe mishit në kraharor, është epiqendra e shpirtit dhe nga njëra anë ajo sheh drejt kësaj bote, e nga ana tjetër, ajo mban vesh drejt botës së shpirtrave. Veprimtaria emocionale e njeriut dhe ndërveprimi i tij me ndjenjat kryhet me anë të zemrës, dhe doemos aty fle edhe lumturia, e herë-herë po aty strehohet edhe mërzia. Një njeri i vetëdijshëm për qenësinë e tij, duhet që, ashtu siç kujdeset për fizikun e jashtëm, të punojë që të mirëmbajë edhe anën e brendshme, ndaj Mbreti i Njerëzimit dhe Sulltani i Fjalës na porosit kështu:

"Shikoni, brenda trupit të njeriut ka një copë mishi e cila kur është mirë, i gjithë trupi ndihet mirë, e kur ajo sëmuret, bashkë me të sëmuret tërë trupi. Kujdesni! Ajo është zemra." Sipas Imam Gazaliut, meqenëse zemra është e fshehur prej nesh, e ne s'kemi kontroll somatik mbi të, atëherë shërimi i saj kërkon mund e forcë. Po aq sa kërkon ëndje për shërim, zemra ka nevojë edhe për mbarëvajtje të pandërprerë. E ndërkaq, njeriu kurrsesi nuk duhet të ketë frikë nga mërzia, sepse ajo është një udhë përqendrimi, një klimë, një atmosferë që e ruan botën e ndjenjave nga rënia në lëndinat e errëta.

Zoti, nuk vëren formën fizike, paraqitjen e jashtme dhe veshjet, porse ai vështron në zemrat e thyera dhe të përvuajtura dhe i përgëzon njerëzit me kumtin "Unë jam bashkë me zemrat e thyera." Forca e besimit, e rizgjuar gjithmonë pas çdo rënieje, rikthehet edhe më e fuqishme aq sa bëhet shkak për zbritjen e mëshirës hyjnore. Çdo thyerje e marrë në zemër është shkak për pohimin e cilësisë dhe atributit hyjnor Shëruesi-Shâfi, dhe se vetë plaga e dhimbjes është një lutje e heshtur që, nën kujën e zemrës, thërret ndihmën e Allahut Mëshirues. Kjo qartësohet edhe me versetin kuranor ku veçohet qëllimi i lartë prej nga ku buron lutja, ku Zoti thotë: "Zoti im as nuk do të kujdesej për ju, sikur të mos ishte lutja juaj..."

Ja, përsëri Rumiu na del përpara me fjalët e tij:

"Mos i shemb shpresat: sille ndërmend Jusufin,
Kudo që të jetë dhimbja, atje shkon shërimi;
Kudo që ndodhet skamja, atje rend furnizimi,
Kudo që ngrihet pyetja, atje mbin përgjigja,
Kudo që të ndodhet anija, atje gjendet ujët."

Furtunat dhe netët me stuhi sjellin gjithmonë kthjellime më të qarta të horizonteve, blerimet pas rrëkeve të shirave janë gjithmonë më rrezëllitëse si dhe agimet pas netëve më të errëta janë më shpresëdhënëse se kurrë; po njësoj, edhe natyra e brendshme e njeriut, edhe uniteti i tij i krijuar prej po së njëjtës dorë, e cila ka krijuar gjithçka, pas çdo vështirësie, vjen edhe qartësohet më shumë drejt kuptimit të Zotit dhe të realitetit të këtij universi. Çdo mëngjes është një lindje e re dhe mërzia e së shkuarës duhet lënë të shkojë siç vërshojnë ujërat dhe ikin. Madje, së fundmi, për të shtuar një krahasim, nëse do të na lejohej analogjia, ashtu sikurse një armë, shuli i së cilës duhet të tërhiqet mbrapsht së pari në mënyrë që të marrë një fishek në fole, që të bëjë përpara më pas, ashtu edhe pas çdo zbritjeje të njeriut fshihet Forca Hyjnore që e shtyn atë vazhdimisht drejt qiejve të ngritjes. Në s'na u realizoftë diçka, kjo ndodh ose ngaqë diçka më e mirë po na vjen, ose ngaqë me të vërtetë është më mirë të mos ndodhë.

BAZAT METAFIZIKE TË SËMUNDJES (2)

Konsiderata mbi sëmundjen

Njëri prej faktorëve më të rëndësishëm(,) që përcaktojnë konsideratën mbi mjekësinë, është qëndrimi ndaj konceptit sëmundje. Ngaqë fakihët (specialistët e së drejtës juridike islame) e kanë nxjerrë në plan të parë aspektin juridik (Islam) të sëmundjes, çështjet lidhur me të sëmurët i kanë shqyrtuar në kapitujt funeralë ose mbi të vdekurit dhe trajtimin e tyre. Kurse specialistët e hadithit, në veprat e llojit sunen (sunetet, traditat) të shkruara sipas kapitujve të fikhut, hadithet lidhur me të sëmurët i kanë klasifikuar në kapitujt "Libri Funeral" (Kitabu'l Xhenaiz) . Në kapitujt lidhur me kufomat (të vdekurit) janë rrëfyer hadithet lidhur me gradat shpirtërore që ua kanë përftuar njerëzve vizita te (tek) të sëmurët dhe sëmundjet, pastaj u është dhënë vend hadithеve mbi vdekjen dhe përtej-vdekjen. Kjo metodë klasifikimi është kuptimplote nga këndvështrimi që tregon se myslimanët nuk e shohin ftohtë imazhin e vdekjes, por e konsiderojnë vdekjen pjesë të jetës.

Imam Buhariu (vd. 256/870), kapitullin e 22-të të veprës El-Xhamiu's-sahih e ka veçuar për "Kitabu'l-Xhenaiz", në kapitullin e 76-të ka shqyrtuar hadithet mbi mjekësinë dhe kapitullin e 75-të e ka klasifikuar si "Kitabu'l-Merda" (Libri i të sëmurëve). Në librat themelorë të hadithit të njohura si Kutub-i Site, vetëm në veprën e Buhariut ndodhet një kapitull më vete mbi të sëmurët. Në këtë kapitull, nën 22 tituj tematikë ka klasifikuar 37 transmetime (hadithe). Nën titullin e parë ka shqyrtuar "Transmetimet mbi Kefaretin e Sëmundjes". Duke e përmendur ajetin që thotë, "Kush bën një punë të keqe, e heq dënimin e saj" , tërheq vëmendjen mbi lidhjen e gjendjeve të pakëndshme që u bien njerëzve në kokë, me vullnetin e tyre. Në hadithet e rrëfyera më pas, përcjell hadithe që tregojnë se çdo lloj sëmundje dhe shqetësim ka një dimension shpirtëror. Kurse kreu i pjesës së tretë është në këtë formë: "Ndër njerëzit, ata që u janë nënshtruar sëmundjeve (fatkeqësive) më të rënda janë profetët, pastaj ata që u ngjajnë profetëve". Me hadithet e rrëfyera në këto tri pjesë, tregohet se sëmundjet nuk janë e keqe, sepse krijimi i sëmundjes ka një sërë urtësish, se çdo shqetësim i vogël a i madh dhe sëmundja që i bie njeriut mbi kokë është kefaret (kompensim) për mëkatet. Ka mundësi që, duke menduar se njerëzit do ta kenë të vështirë t'i pranojnë aspektet pozitive të sëmundjes, Imam Buhariu ka rrëfyer në pjesën e tretë hadithin që tregon se sëmundjet më të rënda u kanë rënë në kokë profetëve.

Klasifikuesi i sunen-it, Imam Ebu Davudi (vd. 275/888), e ka filluar pjesën lidhur me kufomat (të vdekurit) me kreun që bën të ditur se sëmundjet janë kompensim për mëkatet. Në hadithin e parë të përmendur në këtë kapitull, tregohet një udhëtim i Profetit (a.s.). Gjatë udhëtimit të bërë në anët e Sirisë, duke pushuar nën një pemë, i Dërguari i Allahut (a.s.) po u shpjegonte sahabeve sëmundjet dhe po u thoshte: "Besimtarit i vjen një sëmundje, pastaj Allahu ia heq sëmundjen dhe i jep shëndet. Kjo sëmundje është kompensim për besimtarin për mëkatet e së kaluarës dhe, për të ardhmen, kështillë. Kurse hipokriti që sëmuret dhe pastaj shërohet, i ngjet devesë. Kur sëmuret, të zotët e lidhin devenë në një vend dhe, kur përmirësohet, e lënë të lirë. Deveja nuk e di as pse u lidh dhe as pse u la e lirë."

Vështrimi i të sëmurëve si njerëz që janë goditur nga fatkeqësi materiale (të kësaj bote) si pasojë e mëkateve të tyre, është ndaluar me një gjuhë të hapur e të formës së prerë nëpërmjet hadithеve të përmendura më sipër. Në këto kushte, s'është aspak e drejtë që të sëmurët të shihen me sy nënvleftësues, të ndodhë largimi prej tyre ose disa sëmundje të cilësohen si të mallkuara. Në Islam nuk është lejuar që sëmundja të mallkohet dhe të sëmurët të poshtërohen. Me hadithet me kuptimin "Mos rrini duke i vështruar lebrozët", Profeti (a.s.) e pati ndaluar që të shqetësoheshin qoftë edhe me anë të soditjes të sëmurët me lebër, e cila ka qenë një nga sëmundjet e mallkuara në Perëndimin e mesjetës, kurse lebrozët janë mbajtur të izoluar.

Kur çështja parashtrohet me anë të hadithеve që njoftojnë se sëmundjet vijnë mbështetur mbi një sërë urtësish, se është Allahu i Lartë që e krijon sëmundjen, në mendje na vjen veçoria e ngjitjes te disa sëmundje. Meqë ngjitshmëria e sëmundjes mund të vëzhgohet nga çdokush, njerëzit e konsiderojnë si një të vërtetë të qartë idenë sipas së cilës shkaku i ngjitjes së një sëmundjeje është një i sëmurë tjetër. Madje, në periudhën pagane para islame, arabët besonin se sëmundjet u ngjiteshin personave që bënin vizita tek të sëmurët . Kështu, një beduin pretendonte se deve të sëmura ua kishin ngjitur deveve të tij sëmundjen e zgjebes. Duke e pyetur beduinin, "në është kështu, atëherë, kush ia ngjiti këtë sëmundje devesë së parë", i Dërguari i Allahut (a.s.) na ka tërhequr vëmendjen se sëmundjet i ka krijuar Allahu . Kurse në hadithin e dytë të kësaj pjese, Profeti (a.s.) ka urdhëruar: "I sëmuri (të mos vendoset) të mos rrijë pranë personit të shëndoshë!" . Në shpjegimin e këtij hadithi, El-Baxhiu (vd. 474/1081), duke thënë se "ndërkohë që është Allahu i Lartë që e ka krijuar sëmundjen dhe shëndetin", tregon se zakoni i Tij (në këtë botë) zhvillohet në formën e ngjitjes së sëmundjes, domethënë se edhe ngjitja e sëmundjeve krijohet nga Allahu. . Fakihu (juristi) hanbelit Jusuf b. Muhammed es-Surremerri (vd. 776/1374), faktin që sëmundja ngjitet vetëm me anë të krijimit të Allahut, e shpjegon kështu duke përdorur argumentin e ngjarjes (pas):

"Gjërat e krijuara më pas nuk mund të ekzistojnë, pa një autor, i cili krijon së pari nga hiçi. Është e detyrueshme që

krijuesi i ngjarjes të jetë i gjallë, i fuqishëm dhe i vullnetshëm. Kur kjo të pranohet kështu, sëmundja dhe shqetësimet do të jenë absolutisht të llojit trupa që formohen në shkallë të dytë, pas, te një vend ose person ngjitur ose afër, ose do të jenë një akcidencë e pranishme në trupat. Po qe se krijuesi i ngjarjes është një trup (fizik), është e pamundur të jetë autor i sëmundjes, sepse trupi (fizik) nuk është i gjallë dhe i fuqishëm (haj dhe kadir), i aftë për të bërë. Në këtë aspekt, ekzistenca e sëmundjes bëhet e pamundur. Po të konsiderohet i gjallë dhe i aftë për të bërë, për të krijuar (haj dhe kadir), përsëri kjo është diçka e pamundur, pasi është e pamundur që diçka e krijuar pas të jetë haj dhe kadir. Është absurditet të konsiderohet se akti i një gjëje të krijuar pas ndodhet (efektivisht) jashtë mjedisit të fuqisë ose mundësisë. Po qe se sëmundja është akcidencë, është akoma më jashtë mundësie që kjo akcidencë ta krijojë sëmundjen te dikush tjetër, sepse akcidenca nuk ka jetë dhe mundësi vetiake."

Vështrimi i të Dërguarit të Allahut (a.s.) ndaj sëmundjeve dhe mjekimit të tyre i ka parandaluar kontradiktat mes njerëzve dhe është bërë njëra nga pikat themelore mbështetëse që mjekësia të fitojë një entitet shkencor. Shkencëtarët myslimanë, duke iu bindur autoritetit të mjekëve që kanë përfaqësuar traditën mjekësore antike, në vend që ta braktisnin kërkimin, e kanë analizuar nga e para çdo çështje me të cilën janë përballur nën dritën e ajeteve dhe haditheve. Për shembull, kur në zonën e Sirisë (së sotme) qe shfaqur kolera, Hz. Omeri i pati thirrur muhaxhirët (mekasit) dhe ensarët (medinasit) në grupe veç e veç dhe qe këshilluar me ta. Grupet patën rënë në kundërshtim për të hyrë ose për të mos hyrë në atë zonë dhe për t'u kthyer. Atëherë, Hz. Omeri i pati thirrur pleqtë e kurejshve që qenë bërë myslimanë gjatë çlirimit të Mekës dhe ata i patën thënë njëzëri që të ktheheshin prapë. Dhe Hz. Omeri pati vendosur të ktheheshin prapë. Në këtë mes, Abdurrahman b. Auf që s'ndodhej aty, pati ardhur dhe pati thënë: "Unë di një hadith mbi këtë çështje. Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (a.s.) të thotë kështu: 'Po qe se dëgjoni se në një vend ka rënë kolera, mos hyni, kurse, po qe se në vendin ku ndodheni ju, bie kolera, mos dilni që aty me mendimin për të ikur nga kolera e për të shpëtuar.'" Me ta dëgjuar hadithin, Hz. Omeri e pati lavdëruar Allahun dhe qe kthyer pas.

KONKLUZION

Sipas besimit islam, baza e çdo gjëje dhe burimi i ekzistencës janë Emrat e Bukur të Zotit. Siç janë esenca e krijimit, emrat ose atributet hyjnore janë edhe burimi i shfaqjeve dhe i transformimeve të ndryshme të jetës. Për t'i treguar variacionet e shfaqjeve të tyre, Esma-i Husna (Emrat e Bukur të Allahut) e transformojnë universin vazhdimisht me anë të një ndryshimi dhe kthimi nga gjendja, në gjendje; po kështu, jetën e njeriut e kthen në gjendje të ndryshme. Secili nga Emrat e Bukur të Allahut ka shfaqjet e veta tek universi dhe njeriu. Shfaqja e secilit emër bëhet shkak që të shfaqen te materia dhe njeriu gjendje të veçanta. Nënvleftësimi i kërkimit dhe i marrëdhënies shkak-pasojë(,) duke i vënë sëmundjet në varësi të besëtytnive, në varësi të një sërë elementesh dhe ngjarjesh misterioze me enigmë të pa zbërthyer që ndodhen në univers, janë pengesa më e madhe para zhvillimit shkencor.

Marrja parasysh vetëm e aspekteve materialë të sëmundjes, është bërë shkak që, me kohë, konceptet i sëmurë dhe sëmundje të vështrohen si një eveniment ekonomik. Për disa njerëz, të sëmurët kanë filluar të shihen si mall tregtie dhe burim të ardhurash. Është e qartë nevoja që ndjehet për një këndvështrim të ri me bosht mëshirën dhe dhembshurinë. Për realizimin e këtij ndryshimi është e domosdoshme që konceptet sëmundje dhe shërim të interpretohen sërishmi. Pranimi se emrat e bukur të Allahut të Lartë (xh. xh.) shihen mbi të sëmurin, do ta ndryshojë edhe qëndrimin tonë ndaj të sëmurëve, edhe vështrimin e mjekëve ndaj të sëmurit. Në këto kushte, mjekësia do të ketë një metafizikë të re e cila t'i përfshijë si një e tërë universin, jetën dhe njeriun.

Profeti ynë (a.s.) e ka nxitur dhe inkurajuar mjekimin, të sëmurët i ka dërguar te mjeku, madje edhe vetë është mjekuar. Kështu, Profeti ynë, si në çdo çështje, edhe në çështjen e mjekimit është bërë shembull për umetin ose bashkësinë e vet. Ai na ka tërhequr vëmendjen edhe për faktin se është e domosdoshme që, për shërimin e personit që mjekohet me barna, të mos e nënvleftësojmë lutjen drejtuar Allahut të Lartë. Ai ka theksuar se s'duhet harruar se është Allahu Ai që krijon shkaqet dhe ndikimet mbi të sëmurin, i cili zbaton shkaqet që mjekësia i sheh të domosdoshme për mjekim, si dhe jep shërim. Kështu, duke treguar se është e domosdoshme të përfitohet nga forca mjekuese e lutjes, ka treguar se si duhet të jetë marrëdhënia fizikë-metafizikë.

Përktheu: Mithat Hoxha

Sakrificat e Sahabëve në misionin e kumtimit të fesë

"Sahabe" quhet çdokush i cili ka parë Rasulallahun a.s. me sy të lirë, që ka jetuar pak kohë me të dhe që i ka besuar atij si profet.

Sahabët janë njerëzit më të mëdhenj të njerëzimit pas profetëve, sepse ata janë edukuar drejtpërsëdrejti nga i dërguari i Zotit a.s. Por që edhe sahabët nuk janë në të njejtën gradë. Patjetër që edhe ata kanë grada devotshmërie të ndryshme nga njëri-tjetri. Ata të cilët besuan në momentet më të vështira në periudhën e Mekës, ata të cilët besuan pas emigrimit në Medine dhe ata të cilët besuan pas çlirimit të Mekës me shumë mundësi janë në grada të ndryshme. Kjo çështje edhe në Kuran dhe Sunet është trajtuar si e tillë. Në ajetet përkatëse thuhet qartë ndryshimi i Muhaxhirëve dhe Ensarëve të parë, ashtu siç theksohet edhe ndryshimi i atyre që besuan dhe u përpoqën për fenë e Allahut para çlirimit të Mekës me ata të cilët besuan dhe u përpoqën pas çlirimit të saj. Njëkohësisht këtë ndryshim e hasim edhe te hadithet e Resulallahut a.s. Ibn Hazmi, duke theksuar edhe mendimin e shumë prej muxhtehidëve të tjerë thotë: "Të gjithë Sahabët janë ehli Xhenet."

Sahabët në Kuran

Në shumë ajete të ndryshme në Kuranin Famëlartë përmenden Sahabët e nderuar.

"Muhammedi është i dërguar i Allahut, e ata që janë me të (sahabët) janë të ashpër kundër jobesimtarëve, janë të mëshirshëm ndërmjet vete, ti i sheh kah përulen (në rukuë), duke rënë me fytyrë në tokë (në sexhde), e kërkojnë prej Allahut që të ketë mëshirë dhe kënaqësinë e Tij ndaj tyre. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e gjurmës së sexhdes. Përshkrimi i cilësive të tyre është në Tevrat dhe po ky përshkrim është edhe në Inxhil. Ata janë si një farë e mbjellë ku mbin filizi i vet, e ai trashet, përforcohet dhe qëndron në trungun e vet, ajo e mahnit mbjellësin. (Allahu i shumoi). Për t'ua shtuar me ta mllefin jobesimtarëve. Allahu atyre që besuan dhe bënë vepra të mira u premtoi falje të mëkateve dhe shpërblim të madh."

"Allahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) dhe prej ensarëve (vendasve-ndihmëtarë) dhe prej atyre që i pasuan ata me punë të mira, e edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. Atyre u ka përgatitur xhennete, në të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përjetë të pasosur. E ky është fitim i madh."

Duke marrë parasysh se ka shumë ajete në të cilët përmenden Sahabët, po mjaftohemi me kaq.

Sahabët në Hadithe

"Mos thoni fjalë të pahijshme për shokët e mi (Sahabët), edhe sikur njëri prej jush të ketë flori sa mali i Uhudit dhe ta shpenzoi atë në rrugë të Allahut, përsëri nuk mund të krahasohet as me një grusht shpenzim të tyre."

"Njerëzit më të hajrit janë ata që jetojnë në këtë shekull që jam unë. Pastaj ata që vijnë pas tyre (Tabiin), pastaj ata që vijnë pas tyre (Tebei Tabiin)."



"Kush flet keq për shokët e mi, Allahu i mallkoftë. I mallkofshin engjëjt, dhe mallkimi i njerëzve qoftë mbi ata."

Rëndësia e kumtimit të fesë (Teblig)

Tebligu (kumtimi i fesë) është të kumtosh çdo gjë që konsiderohet e mirë dhe të ftosh çdokënd ta pranojë atë. Tebligu është qëllimi i dërgimit të Profetëve.

Në shumë ajete të ndryshme të Kuranit Famëlartë tregohet qartë se detyra kryesore e Profetëve është tebligu.

Në kumtimin e Islamit të gjithë njerëzit janë me të drejta të barabarta. T'ua shpjegosh Islamin të tjerëve është një përgjegjësi e të gjithë myslimanëve pa dallim race, ngjyre, kohe, vendi dhe gjeografie. Kjo sepse të ftosh në Islam nuk ishte veçanti vetëm e hz. Muhamedit a.s. dhe shokëve të tij. Sidomos kur dihet se pas Muhamedit a.s. nuk do të vijë më i dërguar tjetër për njerëzit. Ndërkohë Allahu në Kuran thotë: "Nga ju le të jetë grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit."

Durimi dhe Sakrificat e tyre

Idhujtarët e Mekës filluan presionin dhe torturat kundrejt të Dërguarit të Zotit dhe atyre të cilët pasuan besimin e pastër Islam. Mekasit spiunonin të gjithë ata të cilët takonin Muhamedin a.s. dhe si pasojë ata burgoseshin, rriheshin, liheshin pa ngrënë dhe pa pirë dhe torturoheshin në mënyrat më çnjerëzore, duke i shtrirë pa rroba në rërë të nxehtë, etj. Nuk ishin vetëm njerëzit e dobët pa mbështetje sociale si Bilali Habeshiu, Amari, Suhejbi apo Habab ibn Ereti që ishin të ekspozuar ndaj kësaj dhune, por edhe njerëz me status të lartë në shoqërinë e asaj kohe dhe të pasur, siç ishte Musab ibn Umejri, i cili ishte ndër të rinjtë më të përzgjedhur dhe më të pasur në Mekë. Një djalosh i cili i jepte rëndësi të veshurit bukur dhe të ngrënit mirë deri në momentin që pranoi Islamin. Familja e tij ishte e para që i doli kundër dhe ja shkëputi lidhjet familjare deri në vdekje, sa që, kur ra shehid (dëshmor) në Uhud, ky djalosh me të shkuar të pasur, nuk kishte as rrobë të mjaftueshme për qefin.

Hixhreti

Hixhret do të thotë të braktisësh vatanin për hir të së mirës së fesë, gjë që i dërguari i Zotit, Muhamedi a.s. e bëri në vitin 622, duke u larguar nga idhujtaria e Mekasve për në qytetin e zemrave të buta dhe të etura për besim të pastër, Medine. Mizoria e idhujtarëve Mekas bëri që çdo mysliman të detyrohej të braktiste vendlindjen e tij, mallin, pasurinë dhe familjen. Ndër ta ishte dhe Ebu Bekr Sidiku, Omeri i fortë apo Osmani i pasur. Njerëz këta me pozitë të lartë në atë shoqëri por që kur u larguan, lanë pas familjet dhe pasurinë e tyre. U detyruan të bënin 450 km rrugë në shkretëtirë të nxehtë, duke mos menduar se çfarë do të hanin apo pinin për 15 ditë rrugë shumë të vështirë. Këta njerëz të ndershëm dhe krenarë u ndihmuan nga medinasit mikpritës që u quajtën Ensar.

Vuajtje mbi vuajtje! Sakrificë mbi sakrificë! Por që ata njerëz të papërsëritshëm në historinë e njerëzimit, duruan pa kundërshtuar qoftë edhe një herë të vetme caktimin e Zotit të tyre. Pse? Sepse mbreti i fjalës a.s. u thoshte: "Duroni, sepse vendi ku do të shkoni është Xheneti."

Mesazhi përmbledhës

Sa të vazhdojë njerëzimi nuk kanë për të munguar sakrifikuesit e kësaj feje. Ndoshta feja e Zotit do të pësojë sulme dhe goditje të ndryshme por, ashtu si Sahabët në kohën e tyre, gjithmonë ka për të pasur durimtarë dhe sakrifikues të kësaj davaje (misioni). Ka për të pasur njerëz, të cilët për të shpjeguar fenë e Zotit do të sakrifikojnë nga rehatia e kësaj bote dhe ashtu si Sahabët, do të shpërndahen në vende të ndryshme të botës ku njerëzit janë të etur për besim dhe për vlera njerëzore që burojnë nga hyjnorja. Patjetër që organizimi dhe bashkimi i besimtarëve të shekullit njëzetenjë për të ringjallur fenë e Allahut dhe të Dërguarit të Tij a.s. do të kënaqë Krijuesin dhe Profetin tonë. Themi që do ti kënaqë, nisur nga fjala e Resulullahut a.s. e thënë para 15 shekujsh, pak para ndarjes nga kjo botë: "Bëjini selam vëllezërve të mi!" Sahabët e pyesin, a nuk jemi ne vëllezërit e tu? Ai u thotë se ju jeni shokët e mi, ndërsa vëllezërit e mi nuk kanë ardhur akoma, do të vijnë më pas. Do të vijnë në një kohë të vështirë ku feja e Zotit të nëpërkëmbet dhe Kurani të braktiset dhe të sulmohet. Ata do të jenë mbrojtësit e tyre, duke sakrifikuar ashtu si Sahabët, duke braktisur rehatinë, mallin, pasurinë dhe vendlindjen sa që njerëzit që do t'i shikojnë do të habiten dhe ashtu siç thoshin dikur "këta janë të çmendur" për Sahabët do u thuhet edhe atyre.

Allahu na mundësoftë një besim të shëndoshë dhe një zemër të ndjeshme ndaj fesë së Tij dhe me veprat që do të bëjmë të na mundësojë të ndjekim rrugën e të Dërguarit të Tij a.s. dhe Sahabëve të nderuar.



Idhujt e gjallë:
Lat, Uzza dhe Menat

Kurani i emërton në veçanti tre idhuj . . .

Por, pse?

Sipas renditjes së shpalljes, emrat e idhujve për herë të parë përmenden në suren En-Nexhm. Pra, gjatë gjashtë viteve të Shpalljes, askund nuk përmenden emrat e idhujve. Për herë të parë përmenden në suren En-Nexhm:

"E ju, a i shihni Latin dhe Uzanë?

Dhe atë të tretin e të fundin, Menatin (a kanë fuqi si Zoti i Muhammedit, e ju i konsideroni zota)!" (En-Nexhm, 19-20)

Pastaj, pason shpjegimi kush janë ata:

"Ata (që i adhuroni ju) nuk janë tjetër, vetëm se emra që ju dhe prindërit tuaj i emërtuat; All-llahu nuk zbriti për ta ndonjë fakt. Po ata (idhujtarët), nuk ndjekin tjetër vetëm se paragjykime dhe çka duan vetë, megjithëqë prej Zotit të tyre u pat ardhur udhëzimi."

(En-Nexhm, 23)

Emra që ata i emërtuan (esmaen semmejtumuha). Atë që epshet e tyre dëshiruan (tehual-enfus).

Andaj, idhulli nuk është tjetër pos emër i epsheve dhe dëshirave që gjenden në botën e brendshme të njeriut. Njerëzit këtyre emrave u japin rëndësi, duke iu dhënë prestigj dhe i adhurojnë.

Nuk depërtojnë në këta emra dhe krijojnë paragjykime rreth tyre, të cilët anojnë t'i copëtojnë nga atomi. Të thyesh idhujt d.m.th. të rrënosh paragjykimet rreth vetit.

Edhe pse idhujt janë vetëm disa emra, simbolet e të cilëve, për nga pjesa e jashtme, u ngjajnë pasioneve dhe dëshirave, dhe që janë të bërë nga druri dhe gurët, por përse këta idhuj Lat, Uzza dhe Menat të bërë nga druri dhe guri, edhe sot e kësaj dite valëviten? Përse këta emra përmenden në Kuran, cila është rëndësia e tyre?

Këta idhuj duhen të jenë të gjallë, vijnë nga dëshira e nefsit, "emërtimi" i tyre bart kuptim dhe janë lëndë adhurimi.

Dhe kjo çfarë kuptimi!

Dhe kjo çfarë adhurimi!

Të shohim!

Fjala "Lat" etimologjikisht është version i kthyer që d.m.th. "Zot" dhe paraqet autoritet absolut (ilah). Rrënja e fjalës arabe që është përdorur për termin e përmendur arrin deri te prejardhja hebraike në periudhën antike dhe paraqet "gjë me të cilën udhëhiqet nga brenda", d.m.th. bindje absolute, autoritet. Pra, emri "Lat" është ekuivalent i fjalës "autoritet", të cilin ne e përdorim sot.

Fjala "Uzza" e plotëson. Në Kuran përmendet me kuptimin "aziz" e që nënkupton "forcë", "fuqi". Emri "Uzza" është ekuivalent i asaj që ne sot e quajmë "forcë", "fuqi".

Ndërsa, emri "Menat" është shumë i njohur. Kjo është ajo që ne e quajmë "para" (Menna, Mamun, Money, Manat). Valuta e mbretërisë ruse ka qenë "manat". Sot, Azerbejxhani dhe Turkmenistani shërbehen me valutën "menat".

Andaj:

Lat - Pushtet;

Uzza - Forcë;

Menat - Para.

E lexojmë edhe njëherë versetin me kuptimin e sotëm: Autoritet, forcë dhe para. Këta nuk janë asgjë tjetër pos emra që ju dhe pasardhësit tuaj u keni dhënë. Këta janë të dyshimtë dhe pjesë e dëshirës së nefseve.

Dëshirat dhe pasionet janë pushteti, forca dhe paratë. Për t'i arritur, sytë e tyre nuk shikojnë asgjë tjetër dhe si lëndë adhurimi krijojnë nga ata idhuj. Dëshirojnë për vete të marrin pushtet, forcë dhe para. Nuk ka kostum që nuk e veshin për të grabitur këto. Për këto luftojnë, goditen, derdhin gjakun dhe bëjnë çrregullime.

Autoriteti: shteti, sundimi, froni, lideri, sovraniteti, kufiri, kombi;

Forca: armët, nafta, toka, banorët, penetrimi;

Paraja: kapitali, banka, ari, argjendi, dollari, euro.

Vallë, a nuk derdhet gjaku për shkak të këtyre dhe bëhen çrregullimet?

Kini kujdes në periudhën në të cilën jetojmë.

Nga forca e adhurimit lindi fashizmi. Nga lakmia për para lindi kapitalizmi. Problemi i përhershëm i njerëzimit nuk është asgjë pos këtyre të triave: Lat (pushtet), Uzza (forcë) dhe Menat (para).

Çfarë thotë Kurani kundër kësaj tresheje?

La ilahe il-lall-llah - Nuk ka autoritet pos Allahut.

La haule ue la kuuete il-la bil-lah - Fuqia dhe forca është vetëm e Allahut.

Lehul Mulk - Pushteti është i Allahut.

A kemi kuptuar përse emra e tyre janë të përmendur në Kuran?

Këta janë emra që nuk vdesin te njerëzimi.

Gurët u zhdukën, por jo edhe froni.

Këta janë idhuj të gjallë: Lat, Uzza dhe Menat . . .

Përktheu dhe përshtati:
Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi

Orteku
I PUNËVE TË MIRA

Allajbegia është një nga 22 fshatrat e Maqellarës, por nga vlerat dhe historiku i kalon përmasat e një fshati të zakonshëm. Nëse do i referoheshim historisë, të paktën do të dallojmë tre kulme, që i japin pikërisht ato vlera dhe ato veçori.

Allajbegia është një vendbanim gjashtë mijë vjeçar, ndër më të vjetrit, jo vetëm në Shqipëri, por dhe në Ballkan. Kjo nuk është një shprehje e hedhur në ajër, por e bazuar në kërkime të mirëfillta shkencore nga dy ekspedita arkeologjike. Herën e dytë, në vitin 2013, në krye të punimeve, në vendin e quajtur "Livadh i Madh", ishte profesori i shquar i Dibrës, Adem Bunguri. Dhe sot e kësaj dite, sa herë që fermerët punojnë tokën me zetorët e tyre në këtë vend, del diçka, send, objekt, që i takon kësaj periudhe dhe e konfirmon atë që thamë.

Një tjetër kulm i këtij trekëndëshi vlerash është dhe xhamia, që është, të paktën, 500 vjeçare. Gurët kuadratikë në muret e saj, të bukur e vezullues, të gdhendur me kujdes, janë dëshmi e qartë e kësaj teze. Ndërtuesi i saj ka qenë sheh Murat begu, një feudal i fuqishëm i asaj kohe, normalisht edhe njeri besimtar. Për fat ajo nuk u prish as në kohën e komunizmit, përveç minares, duke u shpallur monument kulture i kategorisë së parë, që mbrohej nga shteti. Dhjetëra breza besimtarësh, janë falur në atë xhami e ky ritual vazhdon deri në ditët tona, duke hequr mungesën prej një çerek shekulli gjatë viteve të sundimit komunist.

Një tjetër kulm i këtij trekëndëshi është hapja e shkollës së parë shqipe në fshatin tonë, 102 vite më parë. Parvjet organizuam një ceremoni të bukur në nder të kësaj ngjarjeje të rëndësishme. Erdhën miq nga Tirana, nga Peshkopia e Bulqiza në festën tonë. Kryetari i bashkisë, përfaqësues nga drejtoria arsimore, ish mësues e nxënës dhe plot miq e shokë të tjerë. Media të ndryshme dhe televizione i bënë jehonë kësaj ngjarjeje të bukur.

Ishin këto tre kulmet, tre vlerat e pakontestueshme të këtij vendbanimi të lashtë, me njerëz të ditur e fisnikë, që përpiqen t'i ruajnë këto vlera, t'i shtojnë e t'i përcjellin më tej në brezat e tjerë.

Aksioni i radhës

Ajo nisi thjesht, si një lojë, si një puhizë e lehtë, që kthehet në erë të fortë, si një pupël bore, që përbën bërthamën e ortekut të mëvonshëm. Një grup i madh të rinjsh, të ulur në lëndinë, aty pranë dyqanit të fshatit, luanin me letra e diskutonin për problemet e tyre. Mund të kishte plot mënyra të tjera më të dobishme për të kaluar kohën. Ishin ulur përtokë, kur mund të viheshin stola e karrige, qëndronin në diell, kur mund të mbilleshin pemë e të pushonin nën hijet e tyre. Dëshiroja që fuqia e tyre të konvertohej në punë e vepra të bukura, ndaj u afrova për tu zgjuar dëshirat. Dikush tha se mund të mbillnim ca bredha e një tjetër propozoi një lulishte të vogël. Dani, një nga të rinjtë e fshatit, u ngrit në këmbë.

– Na vendos një letër o xhaxhi Osman, aty te dyqani dhe të gjithë të japin sipas dëshirës. Unë, - vazhdoi ai, - po të jap këto 500 euro. Tek ti kemi besim të plotë. Të tjerët le të mendohen.

Urimi, një tjetër, nga grupi i të rinjve, u ngrit në këmbë. Shkoi në shtëpi dhe solli 500

euro, që mi la në dorë, si shoku para tij. Plot njëmijë euro në pak minuta. Ata mjaftonin për të blerë mbi 100 bredha, që do t'i vendosnim anës rrugës.
Lajmi u përhap me shpejtësi. Të nesërmen nxorëm një komision të vogël dhe e dërguam në të gjitha shtëpitë e fshatit. Le të jepnin, kush më shumë e kush më pak, sipas mundësisë e dëshirës. Të gjithë u përgjigjën. Kishte ndonjë familje që dha pesëmijë lekë të vjetra. Aq ishte mundësia e rrethanat. Ndoshta te Zoti i Gjithësisë, ato pak para kishin shumë vlerë, se Zoti nuk obligon njeri më shumë se mundësia. Fjala shkoi deri në Itali, Gjermani, apo shtete të tjerë, kudo ku ishin djemtë e këtij fshati historik. Ata nuk nguruan të sillnin nga 100 euro, më pak apo më shumë, për të kontribuar sadopak në zbukurimin e fshatit. Në pak kohë u pastruan varrezat e fshatit, u hoq rrethimi i vjetër dhe u bë një tjetër, shumë më i bukur, me rrjeta të shtrenjta. U mbollën mbi 130 bredha në të gjithë gjatësinë e rrugës prej 400 metrash. Teksa po bëhej rrethimi, i them Hakiut, një specialist duarartë i fshatit.
– E bëjmë, që e bëjmë gjithë këtë punë, përse nuk i fusim ca tela e llamba ndriçimi, ta prezantojmë veten si qytetarë evropianë. Ai ishte pro kësaj ideje dhe po kështu të tjerët. I blemë 35 abazhurë të bukur, që Hakiu i përshtati dhe i modifikoi shumë bukur. Dy net para Bajramit, kishte përfunduar çdo gjë. Sapo muzgu fillonte të pushtojë hapësirën, rrjeti i ndriçimit krijonte automatikisht një pamje të mrekullueshme, vezulluese, deri në agim.
Ndërkaq, dy sipërfaqe të lira, aty në qendër të fshatit, u konceptuan në formë lulishtesh. U rrethuan me bredha dhe në mes u vunë blina, për tu pasuar më tej me stola, lule dhe elemente të tjerë dekorativë. Nuk do të uleshim më përtokë e në diell, por në stola dhe në hije.

Ndershmëri dhe transparencë

Që kur filloi grumbullimi i parave nga banorët e fshatit, u vu një listë në xhamin e dyqanit, në qendër të fshatit. Ishte hera e parë në tridhjetë vite demokracie, që bëhej një transparencë e tillë. Çdokush mund t'i shihte listat, të gjente emrin e tij dhe shumën që kishte dhënë. Listat qëndrojnë akoma aty dhe askush nuk ka vërejtje për pasqyrimin e të dhënave. Ka dhe persona që nuk janë banorë të fshatit dhe kanë dhënë kontributet e tyre. Musa Riçku është nga Limjani dhe nuk ka asnjë lidhje me fshatin, por dha bujarisht 100 euro. Kjo është vetëm një pikëz nga ato kontribute të shumta, që ai dhe familja e tij dhurojnë çdo ditë, javë e vit, pa u trembur se u pakësohet pasuria. Vetëm në festat e Bajrameve, ai përgatit qindra pako me ushqime për njerëzit në nevojë, me dëshirën që tu kthejë buzëqeshjen dhe shpresat për jetën.
Një tjetër Musa, jo pak i njohur për Dibrën u bashkua me nismën tonë. Ai është ndërtuesi Musa Selami, që bashkë me Mirush Sulën, nipin e këtij fshati, dhuruan bujarisht një paletë me 20 kuintalë çimento të cilësisë së lartë. Fatos Dani nga Podgorica sjell një zetor me zhavorr, kurse Vini, vëllai ynë besimtar, na solli peshqesh pesëdhjetë llamba ndriçimi për abazhurët. Një tjetër emër i bashkohet nismës sonë. Ai është Petrit Besatari që banon në Elbasan. Rrënjët e hershme të tij lidhen me fshatin tonë, ndaj ai afron bujarisht një shumë simbolike ndihme, si dhe një komplet të bukur karrigesh, bashkë me tavolinën.
Listës së personave që ndihmuan bujarisht u shtohen dhe disa vajza të këtij fshati, si Shqipe Xhili, Ferizate Sala, Kujtime Xhili apo Diana Sala, duke kujtuar se u lindën dhe u rritën në këtë fshat të bukur e me shumë histori.
Krahas listës së kontributeve në dritaren e dyqanit, u vendos dhe një tjetër listë. Në të shkruheshin të gjitha shpenzimet që ishin bërë deri tani, me detajet më të vogla. Sa bredha ishin mbjellë, sa hekur, çimento e zhavor ishte blerë? Sa abazhurë ishin përdorur? Sa metra tel e tuba? Të gjitha këto të shoqëruara me faturat përkatëse. Një njeri me shkallë arsimimi minimale, mund të verifikonte, listën e parë, të dytën, të bënte krahasimin e të qetësohej në shpirt, se asnjë lekë i ardhur nuk ishte prishur pa kriter. Listat ishin bërë në tre kopje, që të shiheshin nga të gjithë.
I theksuam të gjithë këto detaje për të dhënë një mesazh të madh, që na ka munguar shumë në këto vite demokracie, transparenca ndaj publikut. Është ky një mesazh që i bëhet klasës politike shqiptare, të majtë e të djathtë, që ka shpërdoruar pa kriter fondet publike. Duhet punuar me duar të pastra, siç bëmë ne në aksionin tonë, që të ndalet eksodi tragjik i shqiptarëve nëpër

botë. Ka ardhur koha që t'i kthejmë vetes dinjitetin dhe krenarinë e të qenët shqiptar.

Të rinjtë, krenaria e fshatit

As që mund të mendohej ky aksion i madh për zbukurimin e fshatit, pa ndihmesën dhe kontributin e tyre. Nëse u shpenzuan mbi shtatë milionë lekë për materiale, po kaq është vlera e punës vullnetare që kanë bërë të rinjtë. Firma ndërtuese Hamja, nga fshati ynë, i bëri pa asnjë lekë të gjitha punimet teknike të rrethimit, që përkthehen të paktën në dy mijë euro. Ata janë tre breza ndërtuesish të talentuar, që nga gjyshi Kadri, babai i tyre Jonuzi dhe tani, ata dy vëllezërit, Flori dhe Miri.

Një tjetër hero i kësaj veprimtarie është dhe Haki Sala, mjeshtri i ndriçimit, bashkë me djalin e tij, Lumin. Që të dy, punuan pa u kursyer aspak, deri në ditën e fundit të punës. Po ta vlerësosh në lekë punën e tyre shkon së paku mbi 500 euro. Rifat Xhili e Lirim Piku punuan bashkë me të rinjtë nga momenti i parë, tek i fundit, duke u bërë shembull dhe frymëzim për ta. Lavdiu, Blerimi, Nesti, Klodi, Urimi, Redoni, Arseni, Joni, Eri, Tini, Vini, Armandi, Konti, Xeni, Genci e plot të tjerë, ishin pjesë e atij grupi të hekurt, që duan ta lartësojnë emrin e fshatit të tyre. Mazar Asllani, shitësi i fshatit, bashkë me djalin e tij, Aldin, nuk iu ndanë për asnjë moment këtij aksioni të madh.

E di që ka dhe shumë për t'i përmendur, por ata nuk e bënë këtë për të shkruar emrin diku, por për një qëllim akoma më të lartë, vetëm Zoti mund t'ua japë shpërblimin. Dy tre ditë para festës, organizuam një iftar si shpërblim moral i asaj pune titanike që ata bënë. Mbi dyzetë të rinj u bënë sërish bashkë në iftarin e organizuar në oborrin e shkollës. Sasia dhe cilësia e ushqimit, por dhe të qenët sërish bashkë, u krijoi bindjen se duke qenë të tillë, si një trup i vetëm, mund të bëjnë punë të mëdha. Nëse në fillim folëm për tre kulme lavdie, këta të rinj i shtuan dhe një kulm krenarie e dinjiteti këtij fshati, duke kapur kuota të reja.

Thuhet se oreksi vjen duke ngrënë, ndaj ne nuk ndalemi në rrugëtimin tonë për të zbukuruar fshatin. Para se të ndryshojmë ambientin, duhet të ndryshojmë mentalitetin tonë, që shpesh le për të dëshiruar. Sistemimi i rrugëve, mbjellja e pemëve të tjera në sezonin e vjeshtës, krijimi i parqeve të reja për fëmijë e për të rritur, janë vetëm disa prej prioriteteve tona. Në mendje na vjen krijimi i një fondacioni me emrin e fshatit, "Allajbegia". Le të jetë ai një dritë shprese, bujarie, për njerëz në nevojë, një burim i pashtershëm për zhvillime pozitive.

Osman Xhili

Isuf Luzaj

Djali i hoxhës së Kaninës, Vlorë
Atdhetari i ditur, mësuesi i filozofëve të së ardhmes

Isuf Muhamet Luzaj (1913-2000), është një figurë e nderuar e përmasave të rritura në kohë, me të cilën krenohen brezat e të tri dimensioneve: të djeshmit, të sotmit, të ardhshmit... Koha i rivlerëson dhe i zbulon vërtetësisht emrat dhe veprat e njerëzve të saj, të cilët i kanë dhënë e i japin, duke i shtuar mirësi kombit, fesë, kulturës atdhetare e asaj mbarë-njerëzore. Harresa bën punën e vet, por kujtesa e zgjuar nduar-nduarshëm prej krijuesit triumfon e jeton jetën e vet të caktuar.

Larguar nga kjo jetë njëzet vjet më parë, në Çikago të SHBA, jeta e Profesor – Doktor Isuf Luzajt kaloi në disa plane kohore: Ndihmesa për çështjen kombëtare, që nga jetësimi, pas ngjizjes; largimi nga atdheu, pas vendosjes së regjimit monist; puna, vepra dhe nderimi shkencor nëpër botë; rivlerësimi i merituar në mjedisin kulturor e social në shekullin e ri...

Në vitin 1984, Presidenti i SHBA Ronald Regan, i dha Prof. Isuf Luzajt medaljen më të lartë në fushën e Arsimit Amerikan: "PROFESOR I AMERIKËS"

Pasuri e vyer është jetëshkrimi i veprimtarisë atdhetare, shkencore, letrare, filozofike; letërkëmbimet me personalitete të shquara të botës së asaj kohe, të mbyllura nëpër baulet e familjes dhe të afërmve, të cilët i ruajnë ato me kujdes të veçantë. Shkencëtar e filozof me përmasa botërore, profesor Isuf Muhameti u detyrua të ndërtonte e të shpërfaqte vlera të mëdha, duke e promovuar emrin e shqiptarit në qendrat më të mëdha shkencore e kulturore të botës, duke aspiruar gjithmonë nderimin e vendlindjes së tij...

Djali i Hoxhës së nderuar, mësuesit të Kaninës dhe i Vlorës atdhetare

Isuf Luzaj lindi në Kaninë të Vlorës, më 21 shkurt 1913, në familjen e Muhamet Hoxhës, imam dhe mësues i njohur. Mulla Muhameti kishte mbaruar shkollën e lartë fetare në Stamboll, ashtu si edhe brezat e mëparshëm ishin ndjekës të fesë islame, arsimimit dhe edukatës atdhetare. Familja e Luzajve banonte në Ujin e Ftohtë dhe kishte miqësi me të gjitha fiset kryesore të ardhur aty nga Labëria dhe nga viset e tjera të vendit. Si hoxhë dhe mësues babai i filozofit të ardhshëm ka përgatitur breza të tërë djemsh të shquar me kontribute të shënuara në fushën e atdhetarisë, shkencës dhe kulturës. Eqerem Bej Vlora në kujtimet e veta e përmend me respekt Mulla Muhametin, si mësues feje dhe edukate; Murat Kapaj (Tërbaçi), xhaxhai i Hysni Kapos, njeri i nderuar, atdhetar, bujar, besnik dhe mikpritës ishte mik i ngushtë dhe përkrahës i familjes Luzaj...

Studimet e para, i pasionuar pas shkencave e kulturës, mësues i shquar

Mësues i parë për Isufin ishte baba Muhameti, prej të cilit mësoi mirë shqipen, turqishten, arabishten dhe elementët e para të frëngjishtes dhe italishtes. Duke qenë nga natyra shumë i zgjuar dhe me kujtesë të fortë, në vitin 1926, djaloshi lab dinte shumë gjëra, megjithëse sapo kishte kryer shkollën fillore në Vlorë. Gjimnazin e nisi në Shkodër, ku në vitin e dytë fitoi bursë nga shkolla për të studiuar jashtë vendit, aplikoi për ta marrë atë, por nuk iu miratua, pa iu treguar arsyet. Në vitin 1933 e mbaroi Gjimnazin dhe u nis për në Paris, ndërsa u detyrua të shesë pjesën e vet të tokës me ullinj, për të vazhduar studimet e larta. Në fillim u regjistrua dhe kreu liceun, pastaj u bë pjesë e Universitetit të Sorbonës, por

nga pamundësia ekonomike u tërhoq nga Franca dhe u kthye në atdhe në vitin 1936. I pajisur me dokumente të rregullta nga shkollat e famshme të Francës, u betua para mbretit Zog, sipas rregullave të kohës dhe filloi punë në Normalen e Elbasanit si mësues frëngjishteje, ndërkohë që shkolla drejtohej nga Aleksandër Xhuvani. U ftua për të filluar punë në Liceun Francez të Korçës, ku u transferua menjëherë dhe dha mësim gjuhën frënge nga viti 1936 deri në vitin 1938. Isuf Luzaj, së bashku me Sotir Kozmosin dhe Enver Hoxhën, ishin të vetmit profesorë shqiptarë. Mori pjesë në Demonstratën e Bukës të mbajtur në Korçë më 28 nëntor 1938 dhe pas kësaj kalon në Institutin Tregtar të Vlorës ku jep letërsi. Nisi të shkruajë letërsi artistike shumë herët, por në vitin 1938 i mblodhi vjershat më të mira dhe hartoi përmbledhjen e parë poetike me titull "Rrëfime". Libri u botua, por nuk arriti të shpërndahej tërësisht pasi autori I. Luzaj u burgos për tre muaj për shkak të poezisë "Neroni", që aludonte kundër regjimit, siç pandehën akuzuesit. Pas 94 ditësh në burg, vjershëtori i ri doli në gjyq dhe u lirua si i pafajshëm.

Brumosur me ndjenja atdhetare, rebel nga natyra, mësuesi i ri Isuf Luzaj, së bashku me 120 studentë, vendosën të luftojnë kundër trupave italiane, të cilët orvateshin të zbarkonin më 7 prill 1939. Shokë armësh ishin edhe Hysni Lepenica, Skënder Muçoja dhe fshatarët nga Sevasteri, Tragjasi, Lepenica e Kuçi, të drejtuar nga Rrapo Çeloja. Labët trima arritën t'i kthenin disa herë varkat e fashistëve pushtues... Pas pushtimit shkollat u mbyllën dhe filloi rezistenca me mënyra të tjera; profesor Isufi organizon dhe udhëheq protestat e djalërisë dhe qytetarisë vlonjate më 28 nëntor 1939, duke mbajtur flamurin e madh shqiptar pa shenjat e sëpatave të Liktorit.

Nga burgjet dhe internimet, në zjarrin e luftës për liri e përparim

Duke mos u pajtuar asnjëherë me pushtimin e vendit nga të huajt, Isuf Luzaj vazhdon luftën me mjete të tjera; organizon rininë, zhvillon propagandë për liri e përparim dhe për këtë vihet në shënjestër të pushtuesve. Arrestohet në Vlorë, burgoset dhe më pas transferohet në Durrës me shkak dyshimin për vrasjen e një polici Italian. Pas disa muajsh e çojnë në Brindisi së bashku me 12 studentë të Institutit Tregtar të Vlorës. Djemtë e Labërisë i mbajnë disa ditë në Gaeta pastaj i degdisin në ishullin famëkeq Ventotene, kamp i madh përqendrimi për të internuar e të burgosur. Aty njihet dhe miqësohet me Abaz Ermenjin, Llazar Fundon dhe figura të tjera të shquara intelektuale dhe atdhetare. Pasi qëndron atje deri në vitin 1942, transferohet në kështjellën e Cortona d'Arezzo, në izolim për shkak se shkroi e përhapi disa vjersha kushtuar Luftës së Vlorës. Aty ra në kontakt me Ali bej Këlcyrën, Mithat Frashërin, Fuat bej Dibrën, Lef Nosin, etj., të cilët ishin marrë vesh të krijonin Ballin Kombëtar, madje kishin shkruar edhe të famshmin "Dekalog". Profesor Isufi ndihmoi në hartimin e këtij dokumenti, duke propozuar të hynte pika e shtatë: " Organizata do të zbulojë vlerat e vërteta kombëtare, do t'i edukojë njerëzit pa marrë parasysh besimin, krahinën ose partinë politike."

Me ndërmjetësimin e Ali Këlcyrës dhe me ndërhyrjen e Ministrit të Arsimit Ernest Koliqi, Isufi lirohet nga burgu dhe kthehet në atdhe në tetor 1942, ku ngre çetat e Ballit në Dukat e Labëri. Komandon në Selenicë luftën çlirimtare, duke dalë fitimtar ndaj pushtuesit, ndërsa në vitin 1943 në fshatin Vajzë futet brenda një autoblinde italiane dhe lufton me trimëri për disa orë...

Me shokët e tjerë patriotë intelektualë merr pjesë fuqishëm në organizimin e rezistencës aktive, duke marrë pjesë në Konferencën e Mukjes, me shumë besim te mundësia e bashkimit për një qëllim të madh.

Thirret në themelimin e Partisë Social – Demokrate me Musine Kokalarin dhe avokat Skënder Muçon, duke themeluar degët në rrethet Shkodër, Tiranë, Vlorë, etj., në 12 tetor 1943. Në rrethana të paqarta politike, duke dashur bashkimin dhe jo përçarjen e forcave atdhetare e intelektuale të vendit, Isuf Luzaj e pikasi drejtimin e luftës demagogjike të veprimtarëve monistë nën influencën jugosllave, por ishte vonë...

Nëpër botë, larg mëmëdheut dhe pranë dijeve, filozofisë, progresit

Duke e parandierë vendosjen e regjimit monist, më 28 nëntor 1944 braktis vatanin, duke lënë në Kaninë gruan me 5 fëmijë të mitur 7, 5, 3, 2 dhe 1 vjeç; vajza e fundit vdes në Kampin e Përqendrimit në Fushë – Krujë, e sëmurë, për mungesë medikamentesh kundër tuberkulozit.

Sapo mbërrin në Itali e arrestojnë si të dyshuar për vrasjen e gjeneral Zaninit dhe burgoset. Nga atdheu majtistët e kërkojnë për ta riatdhesuar, që t'i nënshtrohet gjykimit për "krime lufte". Me ndihmën dhe rekomandimin e Sandro Pertinit, me të cilin ishte njohur në Ventotene, punoi në Bibliotekën e Vatikanit, gjatë vuajtjes së dënim-internimit. Pas amnistisë vendoset në Breshia ku jep mësime në latinisht në një seminar pranë qytetit.

Më 1948 largohet drejt Argjentinës së largët. Ministria e Arsimit atje e punësoi si përkthyes i frëngjishtes, italishtes, latinishtes në gjuhën spanjolle. Në radion "Europa e Lirë" përgatiste edhe lajmet në shqip e gjuhë të tjera, ndërsa shkruan edhe në gazetën "Lapresa". Njihet me Jorge Luis Borges, me një miqësi të frytshme e të dobishme. Më 1957 mbron diplomën për letërsi dhe filozofi dhe menjëherë fillon punë në Universitetin e Buenos-Airesit. Bëhet drejtor i Institutit Francez "La France a l'etranger" në vitin 1960 dhe vizitohet dhe përshëndetet personalisht nga Presidenti francez i asaj kohe Sharl De Gol; emërohet këshilltar i Ministrit

të Arsimit të Argjentinës, përgatit programet e planet akademike për universitetet e atij vendi, dekorohet më 1965 me Medalje Ari nga Universiteti i Buenos Airesit.

Pas kësaj, thirret në Amerikë nga anëtarësia e Ballit, pasi kish vdekur Ali Këlcyra më 1963 dhe më 1965 zhvillojnë Kongresin në Nju Jork dhe e zgjedhin Kryetar të Ballit Kombëtar.

Hyn në konkurs për frëngjisht dhe fillon punë si profesor i filozofisë dhe gjuhës frënge në Universitetin e Nju Hempshajer; unifikon diplomën e marrë në Argjentinë në Uashington D.C. dhe emërohet Shef Katedre, duke punuar si akademik mësimdhënës i letërsisë spanjolle, frënge dhe drejtor i përgjithshëm i Departamentit të gjuhëve të huaja në Barat College – Lake Forest, Ilinois, SHBA. Në Universitetin e Indianas ishte shef katedre, ku programonte dhe drejtonte kurset e 59 profesorëve të filozofisë.

Del në pension më 1980, po duke vazhduar të udhëheqë punën e 87 profesorëve të Universitetit të Ilinois-it, si shef katedre. Më 29 dhjetor 1990 jep dorëheqjen për arsye moshe dhe shëndetësore. Profesor Isuf Luzaj ndërroi jetë në 25 nëntor 2000 në Çikago dhe sipas amanetit, u varros në fshatin e tij të lindjes, në atdhe.

Vepra

Në vitin 1938 ai botoi librin "Rrëfimet". Në këtë periudhe libri me vargjet lirike konfiskohet dhe ai dënohet me 94 ditë burgim. Bashkëpunon me revistën "Përpjekja shqiptare".

Në vitin 1946 përfundon librin "Ideologjia Falimentuese si interpretim materialist i historisë", botuar nga Universiteti Gregorian në Romë. Ka qenë bashkëpunëtor i revistave "Mbrojtja Kombëtare" dhe "Besa", të cilat botoheshin në Kosovë.

Në vitin 1954 boton novelën politike-shoqërore filozofike kundra komunizmit "Lumenjtë derdhen të kuq" në spanjisht (titulli origjinal Los Rios Bajan Rojos), shtëpia botuese "Ultramar".

Në vitin 1965 boton "Metodologjinë për studimet e filozofisë" që është përdorur për shkollat e mesme.

Ndër vitet 1963-90 boton artikuj pothuajse në të gjitha gazetat e Amerikës mbi filozofinë e Historisë së Marksizmit në teori dhe praktikë. Ka lënë 32 vëllime shqip në dorëshkrim. I janë botuar "Gloria e çmendje", Tiranë 1995 dhe "Lamtumira e yjeve", Tiranë 2001.

Nderime

Isuf Luzaj ka marrë titullin "Professor emeritus" në SHBA, një dekoratë që mban shënimin "Profesor i Amerikës" dhe të cilën ia pat dorëzuar vetë presidenti Regan, se kishte dhënë mësim në universitetet amerikane: Harvard, Columbia, Vox Hampshire, Indiana, Ilinois, etj.

Në vitin 1990 Universiteti i Ilinois-it i dorëzon medaljen "Për shërbime të jashtëzakonshme akademike". Në këtë ceremoni merrte pjesë presidenti i atëhershëm i SHBA George H. W. Bush, guvernatori i shtetit të Ilinoisit dhe Sekretari i Arsimit. Në dhjetor 1990 Shoqata e Gazetarëve të Amerikës i jep "Medalje nderi" për 94 artikuj të botuar tek "Edistenologjia e Materializmit Historik".

ROBTË E TË PLOTMËSHIRSHMIT JANË ATA QË...

Ecin në tokë me thjeshtësi dhe, kur u drejtohen të padituri, thonë: "Paqe!". Ata që kalojnë natën, për Zotin, me krye në tokë e më këmbë. Ata që thonë: "Zoti ynë, na e largo dënimin e skëterrës, sepse dënimi i saj është vuajtje e madhe. Një vendqëndrim dhe pozitë e keqe." Ata që, kur shpenzojnë, nuk shpërdorojnë, as janë dorështrënguar, por të matur. Ata që nuk lusin me Zotin zot tjetër, nuk vrasin pa të drejtë një frymë që Zoti e ka ndaluar dhe nuk bëjnë pandershmëri. - Kush e bën atë, gjen dënimin. I dyfishohet dënimi Ditën e Ringjalljes dhe do të jetë në të përgjithmonë i poshtëruar. Përveç atij që pendohet, beson e bën të mira. Të tillëve Zoti ua këmben të këqijat me të mira. Zoti është Falës, Mëshirëplotë. Kush pendohet dhe bën mirë, kthehet te Zoti i penduar. Ata që nuk bëjnë dëshmi të rreme dhe, kur ndodhen në biseda të kota, kalojnë me nder. Ata që, kur u përmenden dëshmitë e Zotit, nuk mbesin shurdhë e të verbër. Ata që thonë: "Zoti ynë, jepna kënaqësi nga bashkëshortet dhe pasardhësit tanë, bëna shembull për të devotshmit." Këta do të shpërblehen me vendet më të larta të parajsës pasi duruan dhe do të gjejnë atje mirëseardhje e paqe. Përgjithmonë. Ç'vendqëndrim dhe pozitë e mirë! Thuaj: "Zoti im nuk do të shqetësohej për ju të mos qe lutja juaj, porse përgënjeshtruat dhe u bë e domosdoshme."

(Kur'an, Furkan: 63-77)

FJALA E MIRË

Allahu na mëson që të themi fjalën e mirë çdo ditë dhe në të gjitha rastet. Ai na udhëzon, gjithashtu, që të përmbahemi nga përdorimi i fjalëve të këqija.

"A nuk e ke kuptuar se si Allahu bëri shembull fjalën e mirë, si pemën e mirë, që rrënjët e saj janë thellë (në tokë), e degët e saj janë lart, e që me vullnetin e Zotit, ajo jep fruta në çdo kohë. Allahu, pra, u parashtron njerëzve shembuj, që ata të mendojnë." (Kur'an, Ibrahim: 24-25)

Allahu na vë në dijeni, që Ai pranon nga ne fjalën e mirë dhe veprën e mirë. Është gjithashtu Ai, që na jep ne fuqi, pushtet dhe një pozitë të lartë në këtë botë dhe jetën tjetër.

"E ti robërve të Mi, thuaju: 'Le ta thonë atë që është më e mira, pse djalli mbjell ngatërresa ndërmjet tyre, e është e ditur se djalli është armik i hapët i njeriut." (Kur'an, Isra: 53)

Allahu na udhëzon me këtë ajet, që të themi fjalën e mirë dhe të flasim me dashuri me njerëzit, ndryshe do t'i humbasim ata. Djalli do të luajë rolin e tij për të na ndarë dhe për të krijuar armiqësi ndërmjet nesh.

Edhe nëse ekziston ndonjë mosmarrëveshje, mospërputhje, grindje apo përplasje mes dy personave, myslimani duhet të thotë fjalën e mirë dhe të bëjë më të mirën për mënjanimin e tyre.

Fjala e mirë është ajo çka njerëzit duhet të kujtojnë, që të përfitojnë prej saj, ta ndjekin dhe të nxisin të tjerët ta bëjnë atë. Fjala e keqe sjell pasoja të këqija, për ata që e shqiptojnë atë. Ajo është si zgjyra që mblidhet brigjeve të lumenjve.

Myslimani duhet të tregojë kujdes për sjelljet e tij, mënyrën e të folurit dhe çdo gjë që vepron. Nëse nuk e bën këtë, nuk mund t'u kërkojë të tjerëve atë që nuk e bën vetë. Tek Allahu është shumë e urryer të thuhet ajo që nuk punohet.

Fjala e mirë dhe fjala e keqe dalin që të dyja nga e njëjta gojë dhe pasqyrojnë personalitetin, pikëpamjen, sjelljen, mentalitetin dhe brendësinë e individit.

Profeti Muhamed a.s. na mëson të themi fjalën e mirë, ose ndryshe, le të qëndrojmë të heshtur. Në një rast tjetër, Profeti Muhamed a.s. këshillon të kontrollojmë gjuhën (të folurit), nëse duam të kemi sukses dhe të jemi të shpëtuar.

Nëse dëshiron të shlyesh mëkatet dhe gabimet e tua, duhet të marrësh nismën për të bërë mirë për veten tënde dhe për të tjerët.

Kontrollo veten, nëse je midis njerëzve të mirë apo jo.

Të bëhesh i mirë dhe të thuash të mirën, duhet që ushqimi yt të jetë hallall, shtëpia jote të jetë e rregullt, të vishesh mirë dhe pastër, mënyra jote e të jetuarit të jetë e rregullt...

Ti vetë duhet të jesh i ndershëm, i sinqertë, zemërhapur, i çiltër dhe i drejtë.

Kur të përpiqesh e t'i zotërosh këto cilësi, ti, padyshim, mund të thuash të vërtetën dhe fjalën e mirë.

PO RREGULLOVE NJERIUN, KE RREGULLUAR BOTËN

Ishte ditë e shtunë dhe ai po lexonte një revistë, që herët me mëngjes. Kur ngrinte kryet nga revista, në mendje i vinte ideja se atë ditë e kishte pushim, ishte fundjavë. "Nuk do të lejoj askënd të ma prishë këtë ditë pushimi", tha me vete.

Por, pas disa çastesh, i vjen i biri i cili i thotë: "Babi, kur do të dalim për shëtitje dhe ku do të na çosh sot?"

I ati e pa me vëmendje dhe në çast iu kujtua se një javë më parë, i kishte premtuar se do të dilnin për shëtitje bashkë në një vend të bukur. Por, sot ai kishte vendosur të mos e bëjë qejfin qeder, të mos dilte fare nga shtëpia, ta shijonte çdo çast të asaj dite pushimi. Pa ditur ç'të bëjë, i hodhi një vështrim revistës që po lexonte dhe në një nga faqet, dalloi hartën e botës. Menjëherë, e grisi faqen ku ishte harta dhe e bëri copa-copa të vogla, të cilat i hodhi lart në ajër para të birit. Pasi ranë përtokë, i tha të birit: "Para se të dalim shëtitje, duhet t'i mbledhësh këto copa letre dhe t'i bashkosh ashtu siç ishin, të bashkosh hartën e botës. More vesh? Ky është kushti!" dhe iu kthye leximit të artikujve brenda revistës. Me vete mendoi: "As profesori më i madh i gjeografisë nuk do të mund t'i bashkojë copat e letrës, e jo më ky buzëqumështi im."

Por, dhjetë minuta më vonë, i biri e befasoi. Ai iu afrua pranë dhe i tha: "Ja ku e ke hartën tënde! A të bëhem gati për të dalë tani?"

I ati u shtang nga ajo që i shihnin sytë dhe si i hutuar e pyeti të birin: "Si arrite t'i mbledhësh copat e letrës kaq shpejt?!"

Djali i vogël ia ktheu: "Kur ti babi më dhe letrën mbi të cilën ishte printuar harta e botës, unë e ktheva nga ana tjetër dhe pashë që në anën tjetër ishte printuar imazhi i një njeriu. Me vete mendova:

"Nëse unë rregulloj njeriun, për rrjedhojë do të rregullohet dhe bota!"

UNË, NJERIU...

Rubini është një gur i çmuar, trëndafili një lule, bleta një insekt... Unë jam njeri. Por cili është vendi im midis tyre? Kush jam unë dhe kujt i përkas?

"Zotin e njeh, kush njeh vetveten!"

Meqë qenka kështu, m'u dashka të njoh më parë vetveten. Duhet ta përdor vetveten si një çelës, për të përcaktuar vendin tim në botë dhe për të njohur Zotin tim. Vetëm atëherë mund të kuptoj çdo gjë në mjedisin që më rrethon, sepse më i rëndësishëm nuk është objekti që vështrohet, por "mënyra e të vështruarit". Po e njoha vetveten, edhe njeriun do të mund ta njoh.

"Pjesët janë pasqyrë e të tërës."

Unë jam njeri... Mbështetjen e kam në tokë, por shpirti më fluturon hapësirave kozmike. Fshehtësia dhe dëshmia takohen tek unë, kuptimi dhe sendi tek unë, bëhen një. Asgjë s'është e imja dhe çdo gjë është e imja. Çdo gjë është për mua dhe unë jam për Allahun. Jam mbreti i botës, por robi i Tij.

I vetëm, jam një hiç. Qenia ime - një hije. Çdo gjë që kam, Ai ma ka dhënë. Unë ekzistoj për Të. Dija ime, vullneti, fuqia, të gjitha këto i kam prej Zotit. Unë ndodhem këtu, për t'i shërbyer Atij si rob. Brishtësinë time e njoh - Fuqisë së Tij i trembem; varfërinë time e kuptoj - Mëshirës së Tij i besoj; të metat e mia i dalloj - faljen e Tij kërkoj...

Te çdo gjë që hedh sytë, shoh atributet e Allahut. Ngado që të kthehem, ndeshem me veprat e Tij. Cilësdo qenie t'ia mbështes veshin në gjoks, më numëron emrat e bukur të Tij...

O VIZITOR I KËSAJ BOTE...

Çdo njeri është një vizitor i përkohshëm në këtë botë dhe largohet, duke lënë pas disa gjurmë në të. Disa nga këto gjurmë mbeten në shekuj, disa të tjera zhduken me largimin e tij. Ata që vijnë pas tij, i ndjekin këto gjurmë; disa prej tyre i ngjasojnë një autostrade, që të çon drejt përsosmërisë dhe përjetësisë; disa të tjera të shpien në shtigje të pakapërcyeshme dhe në mbrapshti.

O vizitor i kësaj bote, po ti çfarë gjurmësh ke vendosur të lësh?

Hatixhja r.a.

modeli i gruas në Islam

"Mos u frikëso!

Allahu kurrë nuk ka për të të lënë që të humbësh, sepse ti i ruan lidhjet farefisnore, thua gjithmonë të vërtetën, e ndihmon nevojtarin, e nderon mikun dhe e përkrah të drejtën."

Kush ishte Hatixhja, e cila mundi të tregonte një forcë kaq bindëse pa dyshimin më të vogël, menjëherë pas dëgjimit të lajmit? Kush ishte kjo grua që e mbështeti dhe i dha siguri Profetit?

Të flasësh për Hatixhen do të thotë të flasësh për vlerat, për moralin, shembullin më të përkryer të gruas myslimane. Nëse do e lexonim jetën e saj, do e rilexonim në mëngjes, pastaj do e përsërisnim në mbrëmje, e nëse do e lexonim në mbrëmje, do e kërkonim përsëri të nesërmen. Po cila është arsyeja? Arsyeja qëndron në atë se Kurani e ka përjetësuar kujtimin e Hatixhes. Kurani nuk të mërzitet sado që të përsëritet, sepse bukuritë dhe madhështitë e tij janë të pafundme. A nuk ishte ajo që gjithë pasurinë e saj ia dhuroi Islamit? A nuk ishte ajo që nga një njeri i pasur u bë një njeri i varfër? Hatixhja, imazhi i një gruaje me vlerat më të larta në xhahilijet, imazhi i një njeriu që i dhuroi bindjen dhe zemrën Islamit para se të dhuronte mallin e saj në rrugë të tij. Gruaja më e dalluar e Mekës sipas origjinës, pasurisë dhe mendjemprehtësisë. Gruaja më e pasur e Gadishullit të Arabisë. Një grua fisnike dhe e arrirë në karrierën e saj, e bukur, bujare, me zemër të dëlirë dhe e ndershme. Shumë pasanikë të asaj kohe e kishin kërkuar, por ajo i kishte refuzuar. Nuk kishte ardhur momenti dhe as personi që arrinte vlerat e asaj. Caktimi i saj ishte të ishte bashkëshortja, shoqja e jetës së Krenarisë së Njerëzimit. Në fëmijërinë e tij një jetim, në rini një punëtor që kujdesej për tregtinë e saj dhe në moshën 25 vjeçare bashkëshorti i saj. Një propozim nga ana e saj bëri bashkimin e dy njerëzve më të denjë të njerëzimit. Gruaja e parë e profetit Muhamed (a.s) që i qëndroi besnike dhe e para që e pranoi atë si profet. Në moshën 40 vjeçare në Ramazan erdhi koha e Profetit Muhamed për të marrë detyrën më të madhe të tij nga ana e Allahut (Shpalljen Hyjnore). Profeti (a.s.) ishte në shpellën Hira ku iu shfaq engjëlli Xhibril, i cili i tha: -"Lexo!" -"Unë nuk di të lexoj", – tha ai. Xhibrili e shtrëngoi dhe i tha përsëri: -"Lexo!" -"Unë nuk di të lexoj", – u përgjigj ai. (tri herë). Pastaj zbritën pesë ajetetet e para të sures Alak: "Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më Bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me penë. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte." [Surja Alak, 1-5] Pas kësaj ndodhie, menjëherë Profeti (a.s.) i frikësuar shkoi te Hatixhja, e cila e qetësoi me fjalët: "Allahu kurrë nuk ka për të të lënë që të humbësh, sepse ti i ruan lidhjet farefisnore, thua gjithmonë të vërtetën, e ndihmon nevojtarin, e nderon mikun dhe e përkrah të drejtën." Këto ishin fjalët që Hatixhja i tha bashkëshortit të saj, të Dërguarit të Allahut. Ajo e ngushëlloi dhe e shtrëngoi fort, duke i larguar dyshimet atij. I vetmi person që mund ta ndihmonte, ta lehtësonte dhe ta bënte të

shihte më qartë. Aty bashkë me Profetin filloi dhe misioni i Hatixhes: t'i qëndronte pranë në misionin më të bukur të jetës së tyre. E mbështeti moralisht dhe financiarisht. Në syrin tonë ajo njihet si njeri i pasur, por pasurinë e vërtetë ajo e shpenzoi në rrugë të Allahut, e kushdo që shpenzon në rrugë të Allahut është i pasur. Trokiste derë më derë me shpresën se dikush do përqafonte Islamin dhe nuk u step në asnjë moment të saj, pavarësisht sfidave dhe kundërshtimeve të mëdha. I dhuroi profetit vajza dhe djem dhe i rriti me moralin më të bukur islam. Nuk jemi të përjetshëm në këtë botë, po ashtu dhe për Hatixhen që po vinte dita të largohej nga kjo botë, por ajo nuk u harrua kurrë nga Profeti Muhamed (a.s.). Dashuria e Profetit për Hatixhen ishte shumë e madhe, me të cilën ai kaloi ditët më të trazuara. Askush nuk mund të zinte vendin e kësaj gruaje të paarritshme, e cila përveçse ishte ndër të parat që besuan, qëndroi e fortë dhe e palëkundur, besnike e Islamit deri në ditën që do të ndërronte jetë. Kur e pyeste Aishja se cila është arsyeja e dashurisë së Profetit për këtë grua, Krenaria e Njerëzimit do t'i përgjigjej: "A ka pasur ndonjë tjetër si ajo? Betohem në Allah se Ai kurrë nuk më ka dhënë ndonjë më të mirë se ajo! Kur njerëzit më kundërshtuan në mosbesim, ajo erdhi te unë dhe besoi. Kur njerëzit më akuzuan për gënjeshtar, ajo konfirmoi ato që unë thosha. Kur njerëzit m'i morën pronat, ajo më solli gjithçka kishte dhe m'i fali mua. Dhe Allahu nuk më dha fëmijë me asnjërën përveç saj."

E si mund të harrohej një besnikëri e tillë? Si bashkëshorte e robit më të dashur të Allahut, ajo do të merrte titullin "Nëna e besimtarëve", një titull i dhënë nga Allahu.

Abdullah ibn Abasi tregon, se një ditë profeti (a.s.) hoqi katër viza në tokë dhe i pyeti shokët e tij se çfarë nënkuptonin ato viza. Ata me respekt të madh iu përgjigjën, se ai e dinte më mirë. Më pas ai u tregoi se katër vizat paraqisnin gratë më të larta e të nderuara të Universit: Hatixhe bint Huejlidin, Fatime bint Muhamedin, Merjem bint Imranin (nëna e profetit Isa a.s), dhe Asije bint Mazahimin (gruaja e Faraonit), (Zoti qoftë i kënaqur me të gjitha). E para dallohet si nëna e të gjithë besimtarëve, e dyta, Fatimja, bija e profetit (a.s.), u përgëzua se do të jetë e para e grave të parajsës. Merjemja e pastër, është e vetmja grua, që lindi Isain, profetin e Allahut, pa u prekur nga ndonjë burrë. Asija, gruaja e përkushtuar e Faraonit të lig, e kishte këshilluar burrin e saj, që ta pranonte Musain (a.s), kur ai ishte foshnje. Ajo jo vetëm që e rriti atë në pallatin e Faraonit, por ishte dhe e para që besoi atë që predikoi Musai (a.s.). Çdo kohë e vështirë gjatë historisë ka prodhuar gra heroina, Hatixhja ishte një nga heroinat e para të Islamit, por edhe në ditët tona me shembullin e përkryer që la pas. Zoti e zgjodhi atë si myslimanen e parë, e zgjodhi si bashkëshorten ideale të Profetit të njerëzimit, e zgjodhi si modelin e gruas në Islam.

Jonida Cikalleshi
Teologe, Përgjegjëse e Zyrës së Gruas, Korçë

| FATMA GUNDUZ |

Kruajtja, një mënyrë si na "flet" lëkura jonë

Ndonjëherë, ndodh që kemi kruajtje të shpinës dhe kruajtja e saj pikërisht në atë vend, na mbush me një ndjenjë të çuditshme lumturie. Herë të tjera, ju vëreni një puçërr nga pickimi në krah dhe një skuqje e ngjashme me një kokërr të vogël që shfaqet atje. Oh, këto mushkonjat! Rrallë ka të ngjarë të kapësh një mushkonjë në veprim dhe ndonjëherë madje ndjehet sikur pickimet e tyre thjesht shfaqen nga hiçi. Ndërsa kruani flluskën për të qetësuar ndjenjën e kruajtjes, sytë tuaj skanojnë dhomën për të lokalizuar këtë insekt të bezdisshëm. E shihni atë në një mur, duke u ngopur me gjakun që thithi nga ju. Ju nuk mund të mos mendoni tani: Pse pickimet e tyre lënë gjithmonë kaq kruajtje? Apo madje, cili është qëllimi i kruajtjes në fund të fundit?

Kruajtja është një ndjenjë e pakëndshme që ne e perceptojmë nga lëkura dhe mukozat dhe një ndjenjë, herë pas here, e pakëndshme dhe nganjëherë shumë ngacmuese.

Kruajtja, ashtu si dhimbja, është një ndjesi e brendshme për trupin tonë për të mbrojtur veten. Thjeshtë mënyra se si "flet" lëkura jonë. Në të vërtetë kafshët, madje edhe peshqit, kruhen gjithashtu. Kur kruhet, lëkura jonë instinktivisht dhe në gjuhën e vet na thotë: "Ka diçka që më shqetëson dhe dua që ju ta largoni menjëherë nga unë!" Nëse nuk do të ishte për kruajtjen, ne nuk do të vinim re një merimangë që ecën në krahun tonë. Ne nuk do të shqetësoheshim nga merimangat dhe parazitët e zgjebes apo edhe kërpudhat që vendosen në lëkurën tonë dhe ne as nuk do të përpiqeshim të mbroheshim nga këta parazitë dëmtues.

Një pacient i zakonshëm me zgjebe ka një numër mesatar prej rreth 15-20 parazitësh të rritur në lëkurën e tij. Në rastin e zgjebes norvegjeze, e cila më së shpeshti vërehet tek të moshuarit, ata që qëndrojnë shumë në shtrat, njerëzit me sistem imunitar të dobësuar seriozisht, ose ata që nuk janë në gjendje të kruhen mjaftueshëm, ka mijëra parazitë nën koren e trashë të lëkurës. Kruajtja përshpejton qarkullimin e gjakut në pjesët e kruara dhe indet praktikisht përgatiten për të luftuar infeksionin nga qelizat e gjakut. Megjithatë, miliona njerëz vuajnë gjithashtu nga kruajtje kronike dhe kruajnë lëkurën e tyre shumë më tepër se zakonisht. Për ta kuptuar këtë, duhet të bëjmë një udhëtim nga lëkura në trurin tonë.

Lëkura e njeriut përbëhet nga tre shtresa: epiderma, derma dhe nënlëkura (e njohur edhe si hipodermë). Shtresa e dermës në mes bën zgjatime të ngjashme me gishtërinjtë lart në epidermë. Në krye të këtyre zgjatjeve gjenden mekanoreceptorë dhe mbaresa nervore që lejojnë lëkurën tonë të ndjejë stimujt (siç është temperatura, mprehtësia, presioni, dridhja, dhimbja ose kruajtja). Me këta receptorë, lëkura jonë funksionon si një nga pesë organet tona shqisore dhe më shumë si një "sistem alarmi" i trupit tonë kundër ndryshimit të kushteve të jashtme. Ky sistem alarmi është krijuar në mënyrë të përsosur që secili komponent e di saktësisht se çfarë stimuli të zbulojë dhe të sinjalizojë.

Më parë, mendohej se dhimbja dhe kruajtja ndjeheshin nga të njëjtët receptorë (nociceptorët) dhe që stimuluesit e lehtë ishin përgjegjës për kruajtjen, ndërsa stimuluesit më

të fortë ishin përgjegjës për dhimbjen. Megjithatë, një kundërshtim ekzistonte, sepse ndërsa dhimbja shkaktonte një refleks të shmangies, kruajtja aktivizonte refleksin e kruajtjes. Vitet e fundit, u zbulua se receptorët (pruriceptorët) që perceptojnë ndjesinë e kruajtjes në lëkurë janë përfundimet e lira të fibrave C me shpejtësi përcjelljeje të ngadaltë pa mielinë, që shtrihen në formën e degëve të pemës drejt shtresës së sipërme të lëkurës. Për më tepër, u zbulua se qelizat e lëkurës vetë sillen si receptorët e kruajtjes. Kur marrim një stimul që shkakton kruajtje, siç është pickimi i mushkonjave, i cili lë substanca antikoagulante në lëkurën tonë, mastocitet në indin e lëkurës hidhen në mbrojtje kundër atyre substancave të huaja. Kjo siguron sekretimin e sistemit të mbrojtjes trupore të quajtur ndërmjetës, substanca që prodhohen dhe ruhen nga mastocitet si pararendëse për kushte emergjente. Histamina është më e njohura nga këto substanca dhe është ndërmjetësi më i rëndësishëm në kushtet e kruajtjes. Histamina lidhet me receptorët që gjenden në vetvete në fibrat C pa mielinë që kanë për detyrë zbulimin e kruajtjes në lëkurë. Nëse e konsiderojmë histaminën si një çelës, bllokimi në të cilin përshtatet është në nervin që ndjen kruajtje. Kështu, nervi kruajtës stimulohet nga histamina.

Nervat që marrin këtë stimul lidhen me palcën kurrizore në nivelet e tyre përkatëse dhe e transferojnë mesazhin në një nerv tjetër. Secili prej këtyre proceseve të transferimit është ndërmjetësuar nga një neurotransmetues i caktuar. Mesazhi i fundit i transmetuar trurit përmes këtyre nervave vlerësohet nga truri dhe etiketohet si "kruajtje". Truri përcakton koordinatat e vendndodhjes së kruajtjes dhe porosit veprimin e kruajtjes në sistemin muskulo skeletik. Një udhëtim i ri që përcjell mesazhe nga truri në muskujt e krahut përfundon me kruajtje. Duke marrë parasysh veprimin e shpejtë të fërkimit kur ndiejmë një milingonë që ecën në lëkurën tonë dhe menjëherë përpiqemi ta largojmë, mund të vlerësojmë se sa shpejt dhe përsosmërisht funksionon sistemi i trurit dhe i transmetimit të sinjalit nervor.

Është gjithashtu shumë e çuditshme se si kruajtja është qetësuese, përkundër ndjenjës së saj fillimisht të pakëndshme, pothuajse sikur trupi ynë të na shpërblejë për shpëtimin e tij nga një kërcënim. Ekzistojnë disa arsye për këtë kundërshtim. Kruajtja shkakton një dhimbje me intensitet të ulët në lëkurë. Dhimbja dhe kruajtja

pozicionohen në lëkurë në mënyrë alternative. Transmetimi i ndjesisë së dhimbjes ka përparësi ndërsa transmetimi i kruajtjes është parandalues. Si pasojë, truri ynë ndjen dhimbjen dhe, si përgjigje, sekreton hormonin e quajtur serotonin për të qetësuar trupin. Megjithëse kjo na bën të ndjehemi të qetë për një kohë të shkurtër, truri vazhdon të transmetojë sensin virtual të kruajtjes, duke u lidhur me receptorët që ndodhen në palcën kurrizore përgjatë së njëjtës rrugë nervore me receptorët për serotoninën. Kjo gjendje, e cila mund të cilësohet si një rreth vicioz ndjesi kruajtje-kruajtje, normalisht që e bezdis dhe zemëron pacientin. Kruajtja e së njëjtës zonë në lëkurë vazhdimisht shkakton prodhimin e ndërmjetësve të rinj dhe mbindjeshmërinë e nervave të kruajtjes, të cilat kështu mund ta kthejnë kruajtjen në një shqetësim kronik. Kruajtja kronike shpesh mund të rezultojë si një ndërlikim nga sëmundjet e lëkurës, si zgjebja, morrat, ekzema, sëmundjet e kërpudhave ose alergjitë e ilaçeve. Mund të rezultojë gjithashtu nga një sëmundje sistemike si: insuficienca renale kronike, sëmundjet kolestatike të mëlçisë, problemet e tiroides, anemia e mungesës së hekurit, sëmundjet e gjakut dhe, rrallë, edhe nga kanceret. Kruajtja në sëmundjet sistemike mund të shkaktohet nga ndërmjetësit në lëkurë, por edhe nga neurotransmetuesit në rrugën e ndërmjetme. Kjo lloj kruajtjeje nuk mund të kontrollohet nga ilaçet e quajtura antihistaminikë, të cilat bllokojnë rrugën e histaminës. Ndonjëherë truri do të marrë alarme të rreme të kruajtjes për shkak të kundërveprimeve virale post-herpes Zoster ose dëmtimit të nervit në palcën kurrizore. Episodet e tilla të kruajtjes duhen adresuar për të parandaluar rezultatet e pafavorshme.

Ndonjëherë, arsyeja që mund të shfaqet kruajtja mund të jetë edhe psikologjike kur duket se nuk ka nevojë për kruajtje. Sipas studimit, kruajtja aktivizon qendrën e shpërblimit të trurit që shkakton mekanizmin e varësisë. Pacientët në atë rast janë të entuziazmuar kur kruhen vazhdimisht.

Ndërsa dyert në këtë udhëtim misterioz të shkencës hapen njëra pas tjetrës, ne zbulojmë se asgjë nuk është krijuar pa një qëllim, përfshirë ndjesi të dukshme shqetësuese siç janë kruajtja, e cila, si rezultat, tregon se si komunikon lëkura jonë me ne!

Përktheu: Erion Sukaj

Faleminderit Zoti im

Faleminderit Zoti im që më solle në këtë botë.
Jam i lumtur që mund të dëgjoj, shijoj, prek dhe shoh gjithçka.
Zoti im, më jep shëndet dhe më bëj prej njerëzve që Ti i do.
Të lutem Zoti im, më jep mua dhe njerëzve që dua një jetë të gjatë.
Faleminderit Zoti im që më ke dhënë një nënë të mrekullueshme.
Mami im gatuan ushqime shumë të shijshme.
Ajo qëndron gjithmonë me mua kur jam i sëmurë e në krahët e saj ndihem i sigurt.
Më pëlqen shumë aroma e saj.
Zoti im, lejo që nëna ime të jetë gjithmonë me mua.
Faleminderit Zoti im që më ke dhënë një baba të fortë dhe punëtor.
Zakonisht ai vjen vonë dhe shumë i lodhur nga puna, por gjithmonë gjen kohë për mua.
Unë e dua shumë atë dhe ndonjëherë i bëj surpriza.
Të lutem lejo që ai të jetë gjithmonë me mua.
Zoti im, jepi forcë babait tim.
Faleminderit Zoti im që më ke dhënë një motër të vogël e të bukur.
Para se ajo të lindej, mendoja se prindërit nuk do të më donin më, por e kisha gabim.
Hunda e motrës sime është njësoj si hunda ime.
Jam shumë i lumtur kur luaj me të.
Zoti im, dua që të jem gjithmonë me motrën time.
Nuk dua të ndahem kurrë prej saj.
Faleminderit Zoti im për gjyshen dhe gjyshin.
Gëzohem shumë kur ata më marrin në prehër e më përqafojnë.
Unë i dua shumë gjyshërit e mi, e mërzitem kur ata sëmuren.
Zoti im, jepu gjyshes e gjyshit jetë të gjatë e të shëndetshme.

Më dëgjoni edhe pse jam i vogël



Më dëgjoni edhe pse jam i vogël

– Më keni fëmijë, më doni por mos më llastoni, sepse nuk mund të kem çdo gjë që kërkoj. – Më edukoni që të jem i vendosur, sepse këtë e dua shumë, si dhe vetëm atëherë mund t'i shoh gjërat reale.

– Mos përdorni forcë mbi mua e as trysni, sepse kjo më mëson që të bëhem i tillë në jetë, madje edhe ndaj të pafajshmëve. – Më udhëzoni me këshillë e butësi, bëhuni tolerant kur më mësoni, sepse jam i vogël.

– Mos më premtoni atë që s'mund ta realizoni, sepse nga kërkesat e mia detyroheni të gënjeni, kurse unë mund ta mësoj si gjest normal.

– Unë jam i vogël, shpesh mund të flas fjalë për t'ju shqetësuar juve, por ju gjeni mënyrën dhe metodën që të më ngadhënjeni e jo të bini pre e provokimeve të mia, të cilat, nëse nuk mi evitoni me kujdes, mund të më bëhen shumë të preferuara.

– Si çdo fëmijë, edhe unë kam shprehi të mira e të liga, por ju mos u bëni të tepërt, që të më akuzoni e të më qortoni në çdo kohë e moment, sepse unë kam inat dhe pastaj bëj gabime me qëllim

– Ngaqë jam rritur pak, shumë gjëra di t'i bëj vetë, më lejoni t'i bëj e jo të m'i bëni ju, sepse ma humbisni vetëbesimin e ma shtoni varësinë ndaj jush.

– Të gabosh është diçka normale, por të korrigjosh është humane, andaj, nëse unë gaboj, mos më korrigjoni në prani të tjerëve, sepse s'ka efekt. Do të jeni të suksesshëm nëse këtë e bëni me qetësi kur jemi vetëm.

– Nëse jam në ndonjë situatë jo të pëlqyeshme për ju, nëse më gjeni duke u grindur me shokët, mos më kritikoni në prani të tyre, sepse në ato momente më humb kontrolli e mund t'ju fyej edhe juve. Gjeni mënyrë të butë, më ndani nga ajo zjarrmi dhe pasi të qetësohem, më këshilloni dhe më kritikoni.

– Gabimet që bëj, m'i korrigjoni si prind i mirë, e jo të ma mbushni kokën me fjalën mëkat, mëkat, mëkat, sepse unë jam njeri e jo engjëll, dua të mësohem nga ju që kur të gaboj apo mëkatoj, të di të pendohem.

– Nëse e teproni me kërkesat tuaja që të ju sqaroj pse kam gabuar, sidomos në ato gabime të cilat i kam bërë pa vetëdijen time, më bëni të jem i pasjellshëm dhe fyes edhe me qëllim, ndoshta edhe ndaj jush.

– Frika është pjesë e pandashme e njeriut, sidomos e fëmijës, edhe pse të jem i sinqertë gjithnjë, ndodh që ndonjëherë të gënjej, andaj mos gjykoni gjithmonë në bazë të sinqeritetit tim.

– Nëse gjithmonë vetëm më predikoni, do më bezdisni dhe, nga bezdia detyrohem t'i shpalos edhe të këqijat që di, e ti do çuditesh, madje, edhe do dëshpërohesh.

– Nëse njeri më qorton, të mos më përkrahë tjetri, sepse unë krijoj bindje të gabuar për ju, mendoj që s'keni autoritet e dashuri të ndërsjellë mes vetes.

– Kujdes kur jam në gjumë, mos flisni fjalë a shprehje të ulëta, sepse unë ka mundësi të jem zgjuar por ju nuk e dini.

– Unë i dua filmat, sidomos ata për fëmijë, por i urrej skenat tuaja si në film, kur ju grindeni në praninë time.

– Nëse ju hidhërojnë gjyshërit e mi, mos i fyeni në praninë time, as mos më thoni gjë keq për ta, e urrej këtë gjë sepse unë i dua.

– Nëse s'më edukoni të jem i kujdesshëm gjatë të ushqyerit, do t'ju turpëroj në çdo rast kur ne ushqehemi në prani të tjerëve, por edhe tuajën.

– Para gjumit, nëse s'më edukoni që t'i laj duart, këmbët, dhëmbët e të vishem me pizhame, unë do të shtrihem me rrobat që kam mbajtur dhe luajtur gjatë tërë ditës, këtë e bëj sepse s'kam njohuri që nuk duhet bërë.

– U lodha me kërkesa e dëshira o prindërit e mi, e tëra ka qëllimin që tek unë të formoni identitet dhe personalitet me norma të qarta e të drejta ashtu siç e ka lënë të porositur Muhamedi paqja qoftë mbi të.

Ju do shumë fëmija juaj!

BOTIMET KMSH

MUND TA GJENI PRANË LIBRARISË “MIQTË E LIBRIT”

BOTIM I RI

ME ZOTIN MES NJERËZVE

“NJERIU ËSHTË BASHKË ME ATË QË DO”